



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KRYEMINISTRIA
INSPEKTORATI QENDROR

Inspektorati Qendror, edhe përgjatë vitit 2020, një vit mjaft i vështirë për Shqipërinë, si nga goditja e tërmetit, por edhe prej pandemisë globale, ka vijuar sfidën për vendosjen e veprimtarive inspektuese të të gjithë inspektorateve shtetërore dhe vendore në drejtimin ligjor. Në vitin që lamë pas, kjo sfidë ka vijuar pa ndërprerje në përmbushjen e detyrimeve dhe funksioneve të përcaktuara me ligj.

Inspektorati Qendror, si institucioni nukël, me përgjegjësinë ligjore në përmirësimin e efektivitetit dhe përgjegjshmërisë së veprimtarive të inspektimit në vend, ka udhëhequr Task-Forcën Anti-Covid, me qëllim garantimin e zbatimit të protokolleve të sigurisë në njësitë tregtare, të lejuara të ushtrojnë aktivitetin për periudhën e epidemisë së shkaktuar nga infeksioni COVID-19.

Për më tepër, marrë shkas nga situata e rëndë e krijuar, për uljen e barrës administrative nga inspektimet e shpeshta gjatë periudhës së pandemisë, Inspektorati Qendror bashkërendoi inspektime të përbashkëta, të ushtruara nga Inspektorati Shtetëror Shëndetësor, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut dhe Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore, për marrjen e masave për parandalimin e përhapjes së Covid-19.

Sa më sipër, gjithë stafi i Inspektoratit Qendror, në bashkëpunim me inspektoratet e sipërpërmendura, kanë qenë gjithë kohën në terren duke këshilluar dhe ndërgjegjësuar qytetarët për respektimin e masave anti-covid.

Me gjithë situatën e krijuar, inspektoratet shtetërore, nën udhëheqjen dhe koordinimin e Inspektoratit Qendror, kanë realizuar objektivin kryesor për kryerjen e veprimtarisë inspektuese online nëpërmjet sistemit elektronik “*e-Inspektimi*”, me dokumente standarde, listë-verifikimi, nënshkrim elektronik dhe me sistem GPS dhe Video & Audio recorder.

Inspektorati Qendror, nëpërmjet unifikimit të procesit inspektues, ka rritur në mënyrë të ndjeshme transparencën e procedurave të inspektimit dhe ka në fokus ngritjen e mëtejshme profesionale të inspektorëve shtetërorë/vendorë, me synim rritjen e mëtejshme të besueshmërisë së publikut ndaj procesit inspektues. Vlen për t’u theksuar integrimi në sistemin e inspektimit edhe i 22 njësive administrative të qeverisjes vendore, ku nga specialistë të Inspektoratit Qendror janë trajnuar 573 inspektorë, si dhe janë pajisur me 26 Tableta dhe 5 kite inspektimi për kryerjen e inspektimit, si një proces i rregullt administrativ edhe nga inspektorët vendorë.

Duke marrë shkas nga objektivat strategjike të ndërmarra më parë nga Inspektorati Qendror, atë të ofrimit të ndryshimit rrënjësor në veprimtaritë inspektuese në vend, objektivi jonë është avancimi më tej në këtë drejtim, duke propozuar ndryshimet në ligjin për inspektimin. Këto ndryshime të domosdoshme janë kërkuar nga të gjitha dhomat e biznesit, vendase e të huaja, si

dhe janë pjesë e strategjive të ndërmarra nga Qeveria Shqiptare, e cila ka si qëllim të nxisë masat për të luftuar politizimin dhe korrupsionin, ngritjen e procesit të rekrutimit dhe karrierës profesionale të trupave inspektuese, duke forcuar politikat dhe legjislacionin, me qëllim përmbushjen e standardeve për integrimin në BE.

Inspektorati Qendror është angazhuar me përkushtim për të arritur objektivat në funksion të përmbushjes së detyrimit ligjor, në lidhje me misionin në fushën e veprimtarive inspektuese, pasi kemi synuar gjatë punës tonë të rrisim dhe forcojmë besimin e qytetarëve në blerjen e mallrave dhe shërbimeve, formalizmin e ekonomisë në vend, uljen e barrës administrative, si dhe t'u garantojmë atyre ruajtjen me transparencë dhe përkushtim të burimeve natyrore të vendit.

Puna jonë për përmirësim të vazhdueshëm në këtë drejtim është që nëpërmjet inspektimeve të arrijmë të formalizojmë bizneset dhe t'i krijojmë hapësirë konkurrencës së ndershme, e cila do të garantojë rritje ekonomike të qëndrueshme në vend, si pjesë e zbatimit të reformës ekonomike, e shoqëruar me riorganizimin cilësor të inspektorateve dhe ndryshimin ligjor.

Në emër të stafit, qytetarëve, bizneseve që na kanë besuar, si dhe partnerëve ndërkombëtarë, marrim angazhim, se iniciativa për të krijuar një platformë të re me standard bashkëkohor evropian në fushën e inspektimeve, do të jetë sfida dhe qëllimi ynë kryesor, për të përmbushur marrëveshjen e ndërmarrë në Samitin e Londrës, në 2017 të Qeverisë tonë, si dhe përmbushjen e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim.

INSPEKTORI I PËRGJITHSHËM

SHKËLQIM HAJDARI

TABELA E PËRMBAJTJES

Legjenda e Institucioneve	5
I. Hyrje.....	6
II. Qëllimi.....	7
III. Metodologjia.....	8
IV. Objektivat.....	8
V. Veprimtaria e Inspektoratit Qendror për Vitin 2019.....	9
VI. Raportimi i veprimtarisë së trupave inspektuese sipas ministrive të linjës.....	
Rezultatet e shqyrtimit.....	10
1. Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave	10
2. Ministria e Punëve të Brendshme	10
2.1. Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit	11
3. Ministria e Financave dhe Ekonomisë.....	12
3.1. Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore	12
3.2. Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut	13
3.2.1. Drejtoria e Mbikëqyrjes së Produkteve.....	13
3.2.2. Drejtoria e Pronësisë Intelektuale.....	14
3.2.3. Drejtoria Teknike.....	14
4. Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë.....	14
4.1. Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial.....	15
4.1.1. Drejtoria e Inspektimit të Naftës dhe Gazit.....	15
4.1.2. Drejtoria e Inspektimit të Pajisjeve nën Presion.....	15
4.1.3. Drejtoria e Inspektimit të Pajisjeve dhe Instalimeve Elektrike.....	15
4.1.4. Drejtoria e Labororit Qendror të Kontrollit.....	16
4.2. Autoriteti Kombëtar i Emergjencave dhe Shpëtimit në Miniera.....	17
4.3. Drejtoria e Inspektimit Hekurudhor.....	18
5. Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë.....	19
5.1. Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar.....	19
6. Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.....	20
6.1. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.....	20
6.2. Drejtoria e Shërbimit të Peshkimit dhe Akuakulturës.....	23
7. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.....	24
7.1. Inspektorati Shtetëror Shëndetësor.....	24
7.2. Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore.....	25
7.3. Zyra e Mbrojtjes nga Rrezatimet.....	26
8. Ministria e Turizmit dhe Mjedisit.....	27
8.1. Agjencia Kombëtare e Mjedisit.....	27
8.2. Agjencia Kombëtare e Bregdetit.....	27
VII. Raportimi i Veprimtarisë për Inspektoratet Vendore.....	27
VIII. Raport Monitorimi të Buxhetit për Vitin 2019, IQ.....	28
IX. Konkluzione.....	29
X. Rekomandime.....	30

Legjenda e Institucioneve

AKB	Agjencia Kombëtare e Bregdetit
AKBPM	Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore
AKM	Agjencia Kombëtare e Mjedisit
AKSEM	Autoriteti Kombëtar i Emergjencave dhe Shpëtimit në Miniera
AKU	Autoriteti Kombëtar i Ushqimit
DIH	Drejtoria e Inspektimit Hekurudhor
DING	Drejtoria e Inspektimi të Naftës dhe Gazit
DIPIE	Drejtoria e Inspektimit të Pajisjeve dhe Instalimeve Elektrike
DIPNP	Drejtoria e Inspektimit të Pajisjeve nën Presion
DLQK	Drejtoria e Labororit Qendror të Kontrollit
DPA	Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave
DPAP	Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar
DPI	Drejtoria e Pronësisë Intelektuale
DPM	Drejtoria e Mbikëqyrjes së Produkteve Jo-Ushqimore
DSHPA	Drejtoria e Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakulturës
DT	Drejtoria Teknike
IKMT	Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit
IQ	Inspektorati Qendror
ISHMT	Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut
ISHPSHSH	Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore
ISHSH	Inspektorati Shtetëror Shëndetësor
ISHTI	Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial
VNM	Vlerësimi i ndikimit në mjedis
ZMR	Zyra e Mbrojtjes nga Rrezatimet

I. HYRJE

Inspektorati Qendror, edhe përgjatë vitit 2020, ka vijuar pa ndërprerje aktivitetin në përmbushje të detyrimeve dhe funksioneve të përcaktuara me ligj, për bashkërendimin dhe koordinimin e veprimtarisë inspektuese në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë. Pavarësisht situatës së shkaktuar nga COVID-19, Inspektorati Qendror ka mbikëqyrur dhe mbështetur veprimtarinë inspektuese të inspektorateve shtetërore dhe vendore, me qëllim përmbushjen e objektivave të Qeverisë për kapërcimin e pandemisë.

Referuar zbatimit të planit të veprimit për vitin 2020, në mbështetje të veprimtarisë inspektuese të trupave inspektuese, pati devijime nga ky plan, për shkak të masave të marra dhe përfshirjes së Inspektoratit Qendror dhe disa inspektorateve shtetërore, si pjesë e grupit të Task-Forcës Anti-Covid, drejtpërdrejtë në kontrole të përcaktuara, në subjektet e klasifikuara me rrezikshmëri të lartë, si dhe për ndërgjegjësimin e popullatës për zbatimin e masave të veçanta për parandalimin dhe luftimin e përhapjes së infeksionit të shkaktuar nga COVID-19.

Gjatë periudhës së mbylljes së përgjithshme të shumicës së aktiviteteve në vend, Inspektorati Qendror dhe inspektoratet shtetërore kanë ushtruar veprimtari inspektuese për kontrollin dhe verifikimin e respektimit të masave të veçanta anti-covid, duke bërë që gjatë kësaj periudhe të ndërpriten pothuajse të gjitha inspektimet e programuara për vitin 2020.

Për periudhën Mars-Maj 2020, Inspektorati Qendror, inspektoratet shtetërore, si dhe trupat e tjera inspektuese kanë zhvilluar aktivitetin institucional për identifikimin e problematikave për zbatimin e masave anti-covid dhe adresimin për zgjidhjen e tyre në kushtet e krijuara.

Por, veprimtaria inspektuese edhe për pjesën tjetër të vitit 2020, ka qenë e reduktuar për shkak se vazhdoi aktiviteti në përmbushje të prioritetit kryesor të Qeverisë dhe ministrive përkatëse për marrjen e masave të veçanta në parandalimin e përhapjes së infeksionit të shkaktuar nga COVID-19 dhe kontrollit mbi respektimin e masave nga individët dhe subjektet e inspektimit.

Me gjithë situatën e krijuar, inspektoratet shtetërore, nën udhëheqjen dhe koordinimin e Inspektoratit Qendror, kanë realizuar objektivin kryesor për kryerjen e veprimtarisë inspektuese online nëpërmjet sistemit elektronik “*e-Inspektimi*”, me dokumente standarde, listë-verifikimi, nënshkrim elektronik dhe me sistem GPS.

Ndërsa, Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit dhe Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar, vazhdon të mos kryejë inspektime online, pavarësisht se Inspektorati Qendror, ka siguruar infrastrukturën e duhur, duke përshtatur dokumentet standarde të inspektimit sipas kërkesave të ligjit sektorial, përditësimin e listë-verifikimeve, pajisjen me Tabletë, si dhe trajnimin e trupës inspektuese. Pavarësisht të gjithë masave të ndërmarra nga Inspektorati Qendror, për dixhitilazimin e veprimtarisë inspektuese, IKMT dhe DPAP, ende nuk janë pjesë e platformës elektronike “*e-Inspektimi*”, duke zhvilluar veprimtarinë inspektuese me blloqe.

Për 2020, janë integruar në sistemin e inspektimit edhe 22-njësi administrative të qeverisjes vendore, u trajnuan 573 inspektorë, si dhe u pajisën me 26 tableta dhe 5 kite inspektimi.


Pjesa më e madhe e inspektorateve shtetërore, për shkak të situatës së krijuar nga pandemia, nuk kanë mundur të bëjnë ndryshimet ligjore dhe procedurale, sipas rekomandimeve nga raporti i inspektimit të vitit të kaluar.

Inspektorati Qendror, ka punuar për përmirësimin e veprimtarisë inspektuese, rritjen e efektivitetit të veprimtarisë inspektuese për të gjitha inspektoratet shtetërore dhe vendore, si dhe koordinimin e veprimtarisë së inspektorateve të përfshira direkt në kontrollin dhe verifikimin mbi zbatimin e masave të veçanta për parandalimin dhe luftimin e përhapjes së infeksionit të shkaktuar nga COVID-19.

Inspektorati Qendror, nëpërmjet unifikimit të procesit inspektues ka rritur në mënyrë të ndjeshme transparencën e procedurave të inspektimit dhe ka në fokus ngritjen e mëtejshme profesionale të inspektorëve shtetërorë/vendorë, me synim rritjen e mëtejshme të besueshmërisë së publikut ndaj procesit inspektues.


Gjatë mbikëqyrjes së veprimtarisë inspektuese online të inspektorateve shtetërore dhe trupave të tjera inspektuese, u konstatua se procesi inspektues përgjithësisht kryhej online dhe konform ligjit për inspektimin, dhe akteve të tjera nënligjore, që e rregullojnë këtë proces.

Gjatë vitit 2020, ISH kanë kryer inspektime online të programuara dhe jashtë programit, ku për shkeljet e konstatuara kanë marrë gjithashtu edhe masa administrative gjobë, sipas paraqitjes grafike sa më poshtë:



Masa Administrative Gjobë 2020

- Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave (DPA)
- Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit (IKMT)
- Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore (ISHPSHSH)
- Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut (ISHMT)
- Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial (ISHTI)
- Autoriteti Kombëtar për Sigurinë dhe Emergjencat në Miniera (AKSEM)
- Drejtoria e Inspektimit Hekurudhor (DIH)
- Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar (DPAP)
- Autoriteti Kombëtar i Ushqimit (AKU)
- Drejtoria e Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakultuës (DSHPA)
- Inspektorati Shtetëror Shëndetësor (ISHSH)
- Zyra e Mbrojtjes nga Rrezatimet (ZMR)
- Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM)
- Agjencia Kombëtare e Bregdetit (AKB)



II. QËLLIMI

Ky raport hartohet në përmbushje të detyrimit të ligjit për inspektimin 10433/2011, dhe pasqyron me objektivitet aktivitetin e veprimtarisë së inspektimit dhe të mbikëqyrjes, gjetjet e konstatuara gjatë procesit inspektues duke sugjeruar dhe rekomanduar përmirësimin e këtij aktiviteti.

Inspektorati Qendror, nëpërmjet këtij raporti synon përmirësimin në vazhdimësi të efektivitetit të veprimtarisë inspektuese, për të rritur transparencën e procesit inspektues dhe integritetin e inspektorëve, për të mbrojtur interesin publik dhe garantuar konsumatorin për një cilësi sa më të lartë të jetës dhe shëndetit.

Në këtë raport qartësohet respektimi i akteve ligjore e nënligjore mbi inspektimin, si dhe rregullat dhe procedura e standardizuar për kryerjen e inspektimit, si një proces i rregullt administrativ, nga të gjitha inspektoratet shtetërore në vend.

Raporti synon rritjen e shkallës së përmbushjes së detyrimit ligjor të inspektimit, rritjen e përgjegjshmërisë së trupave inspektuese nëpërmjet kryerjes së kësaj procedure nëpërmjet sistemit të inspektimit të dixhitalizuar, sipas standardeve dhe praktikave më të mira.

Përmbushja e detyrimeve ligjore nga inspektoratet shtetërore konsiston në zbatimin e:

- ✓ Inspektimeve online nga inspektoratet shtetërore dhe trupat e tjera inspektuese, në përputhje me ligjin mbi inspektimin dhe ligjet sektoriale, me dokumente standarde, listë-verifikimi, me sistem GPS dhe me Tabletë, nëpërmjet sistemit unik “*e-Inspektimi*”;
- ✓ Programimin e inspektimit vjetor dhe mujor bazuar në metodologjinë e vlerësimit të riskut për të gjithë inspektoratet shtetërore dhe trupat e tjera inspektuese, në formë elektronike nga sistemi unik “*e-Inspektimi*”;
- ✓ Inspektime për zbatueshmërinë e masave anti – covid;
- ✓ Ndërgjegjësimin e popullatës për zbatimin e masave të veçanta për parandalimin dhe luftimin e përhapjes së infeksionit të shkaktuar nga COVID-19;
- ✓ Bashkërendimin dhe koordinimin e programeve të inspektimit, me qëllim kryerjen e inspektimeve të përbashkëta;
- ✓ Ngritjen e kapaciteteve dhe integritetit të inspektorëve nëpërmjet trajnimeve për ligjin mbi inspektimin dhe inspektimin online;
- ✓ Ndërgjegjësimin e publikut dhe subjekteve të inspektimit mbi platformën e inspektimeve online dhe rëndësinë e arritjes së përputhshmërisë ligjore gjatë kryerjes së procesit inspektues;
- ✓ Trajtimin me përparësi të ankesave të subjekteve të inspektimit dhe qytetarëve, në lidhje me veprimtarinë inspektuese.

III. METODOLOGJIA

Raporti është hartuar në përputhje me kërkesat e ligjit për inspektimin dhe ligjeve sektoriale, nëpërmjet një analize të detajuar të procedurës inspektuese dhe dokumentimit të veprimtarisë së inspektimit të ushtruar, duke marrë në konsideratë faktin se për shkak të rrethanave të krijuara nga COVID-19, nuk është kryer veprimtari inspektuese normale në disa muaj të vitit 2020.

Për më tepër, aktiviteti inspektues konkret i disa prej inspektorateve shtetërore u shqyrtua edhe në bazë të urdhrave të Autoriteteve për inspektimet në kuadër të kontrollit dhe verifikimit për zbatimin e masave të veçanta për parandalimin dhe luftimin e përhapjes së infeksionit të shkaktuar nga COVID-19 dhe mbrojtjes së shëndetit të popullatës. Në bazë të Urdhrit të Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 156, datë 10.03.2020, “Për marrjen e masave të veçanta në parandalimin e përhapjes së infeksionit të shkaktuar nga Covid-19”, si dhe në kuadër të marrjes së masave për zbatimin e protokolleve të sigurisë (mbajtjes së barrierave mbrojtëse nga ana e qytetarëve, me qëllim mbrojtjen e shëndetit të popullatës, nga ana e Inspektoratit Qendror u realizua bashkërendimi i inspektimeve për zbatimin e masave të sigurisë dhe sensibilizimin e qytetarëve për mbajtjen e barrierave mbrojtëse (maskave) nga disa inspektorate, si: AKBPM, AKM, AKU, ISHPSHSH, ISHSH. Këto aktivitete inspektuese dhe sensibilizuese ndikuan në devijimin e programit vjetor të inspektimit për këto inspektorate, duke u fokusuar në emergjencat e situatës.

Raporti i përgjithshëm i inspektimeve është hartuar në bazë të të dhënave të nxjerra nga mbikëqyrja e veprimtarisë inspektuese nëpërmjet sistemit elektronik “*e-Inspektimi*”. Gjithashtu janë shqyrtuar analizat vjetore të inspektorateve shtetërore për vitin 2020, nga ku janë nxjerrë problematikat dhe arritjet kryesore të veprimtarisë së tyre inspektuese.

Procedura e mbikëqyrjes së veprimtarisë inspektuese nëpërmjet sistemit “*e-Inspektimi*”, konsiston edhe në analizën e modulit të programimit, modulit të çështjeve të inspektimit dhe raporte, si dhe regjistri i gjobave, etj., duke shqyrtuar dokumentacionin përkatës të administruar në sistem, përfshirë këtu: programin vjetor, programet mujore të inspektimit, autorizimi, listë verifikimet, procesverbali i inspektimit, vendimi përfundimtar, bazë të dhënash për regjistrimin e gjobave, si dhe dokumente të tjera justifikuese të përdorura gjatë veprimtarisë inspektuese.

Të dhënat janë gjeneruar nga moduli “Raporte” dhe “Moduli i çështjeve të inspektimit”, me anë të filtrave “hapur nga” dhe “mbyllur deri”, për periudhën nga 01.01.2020 deri më 31.12.2020. Në raport janë evidentuar disa nga rastet e gjetura, sipas problematikës së hasur, të cilat nënkuptojnë që ajo problematikë është e shtrirë në të gjithë aktivitetin inspektues të inspektoratit përkatës.

Analiza e veprimtarisë së inspektorateve shtetërore, të paraqitura pranë Inspektoratit Qendror, sipas përcaktimit ligjor, është detajuar në bazë të problematikave të hasura, zgjidhjeve të dhëna, rezultateve të arritura, si dhe objektivave për të ardhmen.

Në vijim të këtij raporti pasqyrohen në formë të përmbledhur arritjet, problematikat, objektivat, për inspektoratet shtetërore dhe trupat e tjera inspektuese të ndara sipas ministrive të linjës, si dhe konkluzionet dhe rekomandimet për përmirësimin e veprimtarisë së tyre inspektuese.

IV. OBJEKTIVAT

Inspektorati Qendror, referuar në objektivat e tij institucionalë, si dhe ato të paraqitura nga ana e inspektorateve shtetërore, ka përcaktuar objektiva të qarta për vitin 2021, lidhur me rritjen e mëtejshme të efektivitetit të veprimtarisë inspektuese, duke siguruar në vijimësi infrastrukturën e domosdoshme për kryerjen e të gjitha inspektimeve online, për rritjen e sigurisë së popullatës, duke bërë të mundur që edhe ato objektiva të vitit 2020, ku pati vështirësi në përmbushje të plotë të tyre për shkak të situatës së krijuar nga COVID-19, të realizohen.

Këto objektiva konsistojnë në:

- ✓ Përmirësimin e zbatueshmërisë së parimeve dhe rregullave të legjislacionit për inspektimin dhe ligjeve sektoriale për fushat e inspektimit që mbulojnë;
- ✓ Programe inspektimi realiste, mbi bazë risku, sipas prioriteteve të fushave përkatëse që ato mbulojnë, si dhe duke zvogëluar kostot e qëndrimit pranë subjekteve të inspektimit;
- ✓ Mbikëqyrjen e veprimtarisë inspektuese online, nëpërmjet sistemit “*e-Inspektimi*”, të identifikojë problematikat, si dhe të rekomandojë përmirësimin e procesit inspektues;
- ✓ Përditësimin e listë-verifikimeve dhe dokumenteve standarde të inspektimit, në varësi të ndryshimeve ligjore;
- ✓ Mbështetjen e IKMT dhe DPAP, për kryerjen e inspektimeve online në sistemin elektronik “*e-Inspektimi*”;
- ✓ Plotësimi i kërkesave dhe nevojave për pajisjen me Tableta të inspektorateve shtetërore dhe inspektorateve vendore për kryerjen e veprimtarive inspektuese online, në sistemin unik “*e-Inspektimi*”;
- ✓ Bashkëpunimi me njësitë e qeverisjes vendore për kryerjen e inspektimeve online, nëpërmjet sistemit “*e-Inspektimi*”;
- ✓ Trajnimin dhe testimin për ngritjen profesionale të trupave inspektuese;
- ✓ Rritjen e transparencës së veprimtarisë inspektuese, për siguruar besueshmërinë e publikut.

V. VEPRIMTARIA E INSPEKTORATIT QENDROR PËR VITIN 2020

Inspektorati Qendror, nëpërmjet aktiviteteve të kryera edhe përgjatë vitit 2020, ka synuar përmirësimin e performancës në tërësi të sistemit të inspektimeve, edhe në lidhje me përballimin e emergjencës së krijuar nga COVID-19, dhe konkretisht:

- ✓ Reformulimi i programeve vjetore dhe mujore të inspektimit sipas situatës së krijuar për përballimin e emergjencës së pandemisë;
- ✓ Hartimi i listë-verifikimeve të reja në përgjigje të inspektimeve në kuadër të masave të veçanta anti-covid dhe implementimi i tyre në sistemin “*e-Inspektimi*”;
- ✓ Koordinim dhe mbështetje të veprimtarisë inspektuese për inspektoratet shtetërore dhe vendore, për rritjen e efektivitetit gjatë kryerjes së procesit inspektues në parandalimin e përhapjes së infeksionit të shkaktuar nga COVID-19, bazuar mbi një sërë aktesh nënligjore mbi zbatimin e protokolleve të sigurisë.

- ✓ Monitorimi në terren i trupave inspektuese në gatishmëri, sipas urdhrave të Inspektorit të Përgjithshëm për gatishmërinë e trupave inspektuese në Republikën e Shqipërisë për kryerjen e inspektimeve dhe kontrolleve për mbrojtjen e shëndetit të popullatës;
- ✓ Janë hartuar ndryshimet ligjore për ligjin për inspektimin;
- ✓ Integrimi i inspektorateve vendore në sistemin unik të inspektimeve “*e-Inspektimi*”, duke i mbështetur nga ana metodologjike për përshtatjen e dokumenteve standarde, hartimin e listë-verifikimeve dhe pajisjen e disa prej tyre me Tableta;
- ✓ Mbikëqyrja e veprimtarisë inspektuese online nëpërmjet sistemit “*e-Inspektimi*”, duke identifikuar arritjet, problematikat, si dhe duke dhënë rekomandime për përmirësimin e procesit inspektues;
- ✓ Trajnimi i inspektorëve vendorë për 22 bashki, sipas një kurrikule trajnimi për njohjen me kuadrin ligjor për inspektimin, si dhe kryerjen e inspektimeve online nga sistemi elektronik “*e-Inspektimi*”; Gjithashtu, për inspektoratet shtetërore janë trajnuar të gjithë inspektorët në periudhë prove, si përdorues të rinj dhe rast pas rasti sipas nevojave të tyre;
- ✓ Për të gjitha inspektoratet shtetërore dhe trupat e tjera inspektuese, në zbatim të pikës 4, të nenit 30 të ligjit nr. 10433/2011, si dhe urdhrave përkatës, me ndryshimin e vlefshmërisë së përdorimit të kartës nga 1 vit në pa afat, u modeluan dhe u printuan gjithsej 943 karta inspektori: (AKU 263; ISHSH 187; ISHMT 62; ISHPSHSH 122; ISHTI 118; IKMT 98; DPA 20; AKSEM 15; AKBPM 18; DSHPA 19; ZMR 9; AKM 1; DIH 11);
- ✓ Përditësimi dhe mbajtja e regjistrit kombëtar të inspektorëve në detyrë për inspektoratet shtetërore dhe për inspektoratet vendore.
- ✓ Hartimi i moduleve për procedurën e vlerësimit, testimin fillestar dhe periodik, si dhe kriteret përkatëse të vlerësimit të inspektorëve shtetërorë.
- ✓ Ka filluar procesi i trajnimit dhe testimin të inspektorëve shtetërorë në periudhë prove.
- ✓ Janë trajtuar rreth 100 kërkesë/ankesa nga individë/subjekte tregtare, lidhur me procedurën inspektuese apo denoncime të ndryshme nga subjekte private.

VI. RAPORTIMI I VEPRIMTARISË SË TRUPAVE INSPEKTUESE SIPAS MINISTRIVE TË LINJËS.

1. Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave (DPA)

Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave është struktura përgjegjëse për zbatimin e legjislacionit arkivor në rrjetin arkivor të Republikës së Shqipërisë, sipas kërkesave të ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003, “Për Arkivat” dhe “Normat tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë”.

Për vitin 2020, DPA kishte planifikuar të inspektonte 230 institucione (subjekte), por për arsye të situatës së krijuar nga pandemia COVID-19 dhe angazhimit të inspektorëve me detyra të tjera, pati devijime nga realizimi i planit, pasi 91 institucione (subjekte) nuk u inspektuan gjatë këtij viti.

Për periudhën kohore Janar-Dhjetor 2020, DPA ka realizuar gjithsej 144 inspektime, 139 të planifikuara dhe 5 të paplanifikuara, nga të cilat 4 inspektime u realizuan me kërkesë të subjekteve private për licencim të aktivitetit “arkivë private”, si dhe 1 inspektim me indicie në një subjekt shtetëror arsimor.

Gjithashtu, janë marrë 6 masa administrative “gjobë”, në 6 institucione (subjekte), për moszbatim të detyrave të lëna nga inspektimi i mëparshëm, me vlerë prej 1,000,000 (një milion) lekë, nga ku është arkëtuar vlera prej 200,000 (dyqind mijë) lekë, si dhe nuk është ankimuar asnjë çështje në gjykatë.

Arritjet: DPA, realizon veprimtarinë inspektuese online, me Tablet, konform ligjit për inspektimin dhe ligjit sektorial, me dokumentacion standard, mbështetur në programin vjetor dhe programet mujore. Ka mbledhur të dhëna arkivore për të gjitha subjektet shtetërore, që përbëjnë rrjetin arkivor kombëtar, duke krijuar “Databazën me institucione”, si një sistem mirëmenaxhimi, i cili krijon mundësinë për inspektime në bazë të vlerësimit të riskut. Ka organizuar 5 seminare 1-ditore në ambientet e institucionit, për trajnimin e punonjësve të sekretari-arkiva.

Problematikat: Gjatë mbikëqyrjes online të veprimtarisë inspektuese për DPA-në, u konstatua se trupa inspektuese e DPA-së, për inspektimet e programuara, duhet të ngarkojë në sistem dokumentin e njoftimit të autorizimit nga subjekti i inspektuar, si dhe dokumentacioni i veprimtarisë inspektuese duhet të plotësohet saktë dhe në të gjitha rubrikat e tij.

Objektivat: Për vitin 2021, në bazë të programit vjetor të inspektimit, është planifikuar kryerja e inspektimeve në 280 institucione shtetërore, ku të gjitha inspektimet do të vazhdojnë të realizohen online dhe me Tableta, sipas ligjit për inspektimin.

2. MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME

2.1 Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit (IKMT)

IKMT, është autoriteti përgjegjës për ruajtjen dhe sigurinë e ndërtimeve në Republikën e Shqipërisë dhe ushtron veprimtarinë në përmbushje të detyrimeve ligjore që rrjedhin nga ligji nr. 9780, datë 16.07.2007, “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, i ndryshuar, VKM nr. 893, datë 04.11.2015, “Për organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit”, i ndryshuar, VKM nr. 894, datë 04.11.2015, “Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit dhe ai i Njësisë Vendore”, si edhe veprimtaria inspektuese nga përgjegjësitë e shtuara në fushën e mjedisit, ujërave dhe pyjeve në përputhje me legjislacionin sektorial.

Në përputhje me ndryshimet e VKM nr. 502, datë 13.09.2017, “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Brendshme”, të ndryshuar, është shtuar fusha e përgjegjësisë së saj edhe në parandalimin, mbrojtjen, mbikëqyrjen dhe kontrollin e zbatimit të legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e tokës, ajrit, ujërave dhe pyjeve nga ndotja, dëmtime apo ndërhyrje të kundërligjshme të çfarëdo lloji.

IKMT është strukturuar me drejtoritë përkatëse në çdo qark të vendit dhe synon të shtrijë dhe të këtë një ndikim më të madh në territor, me qëllim parandalimin dhe minimizimin e ndërtimeve pa leje në territor, parandalimin dhe kontrollin e mjedisit dhe pyjeve nga veprime të kundërligjshme dhe rritjen e ndërgjegjësimit për një mjedis më të pastër në interes të të gjithëve.

Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit vazhdon të mos kryej inspektime online. Pavarësisht se nga ana e Inspektoratit Qendror, është siguruar infrastruktura e duhur duke përshtatur dokumentet standarde të inspektimit sipas kërkesave të ligjit sektorial, përditësimin e listë-verifikimeve, pajisjen me 36 Tabletë, trajnimin e trupës inspektuese, IKMT-ja e zhvilloi veprimtarinë inspektuese me blloqe.

Referuar analizës vjetore të saj, janë realizuar gjithsej 6148 inspektime në territor. Janë prishur gjithsej 487 ndërtime/objekte, prej të cilave: 171 prishje të objekteve të kundërligjshme, 152 prishje të objekteve në kuadër të projekteve të rëndësishme infrastrukturore të qeverisë, si dhe 164 objekte të dëmtuara nga tërmeti i vitit të kaluar. Gjithashtu, janë trajtuar praktika shkresore, gjithsej 3731 ankesa/shkresa/platforma për bashkëqeverisjen.

Për periudhën Janar - Dhjetor 2020, ka marrë gjithsej 428 vendime, nga të cilat: 208 vendime për “Prishje objekti të kundërligjshëm” dhe “Pezullimin e punimeve në ndërtim”; 128 vendime për “Dënim me gjobë”, të vëna në fushën e ndërtimeve pa leje; 10 vendime për “Dënim me gjobë” të vëna mbi zbatimin e ligjshmërisë tek produktet e ndërtimit/burimet ujore; 11 vendime për “Dënim me gjobë”, të vëna ndaj kryeinspektorëve/inspektorëve pranë IMT-ve të bashkive për veprime/mosveprime nga ana e tyre, si dhe 71 vendime për “Dënim me gjobë”, të vëna në fushën e mjedisit, ujërave dhe pyjeve.

Vlera e gjobave dhe e kamatëvonesave është 311,585,000 lekë, ku janë arkëtuar 600.000 mijë lekë dhe shfuqizuar 6 gjoba me vlerë 4,480,000 lekë.

Gjatë kësaj periudhe janë realizuar projektet infrastrukturore të Qeverisë, si edhe ndërhyrje deri në prishjen e strukturave/ndërtimeve përgjatë vijës bregdetare, projektet si: “Infrastruktura rrugore”, “Rikualifikimi urban”, “Punë të realizuara në zona bregdetare, liqenore, lumenj”, punë të realizuara me “Rrezikshmëri të lartë”, prishja e ndërtesave për shkak të rrezikshmërisë së lartë që paraqesin këto ndërtime për banorët dhe ndërtesat përreth, në zonat e dëmtuara nga tërmeti i 26 Nëntorit, në bashkëpunim me institucionet e tjera përgjegjëse dhe të specializuara në fushën e planifikimit dhe ndërtimit në vend, për të filluar procesin e rindërtimit nga organet përgjegjëse.

Gjatë vitit 2020, janë shembur gjithsej 164 objekte në Bashkitë: Tiranë, Vorë, Durrës, Shijak, Krujë, Kamëz, Kurbin.

Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit, me kalimin e përgjegjësive në fushën e mbrojtjes së mjedisit, ujërave dhe pyjeve, ka punuar intensivisht për kontrollin dhe inspektimin në terren, duke marrë masa ndaj subjekteve që ushtrojnë veprimtari të paligjshme në dëm të mjedisit.

Gjoba të vendosura nga IKMT për kundërvajtjet e konstatuara në lidhje me krimet mjedisore në brigjet ujore të vendit (lumenj, dete, liqene, laguna). Në total janë gjobitur 92 subjekte për kryerjen e aktivitetit të paligjshëm në dëm të mjedisit ku janë vendosur 88.2 milion lekë gjoba.

Janë vendosur 10 gjoba mbi zbatimin e ligjshmërisë tek produktet ndërtimit/burimet ujore, 11 gjoba të vëna ndaj Kryeinspektorëve/inspektorëve pranë IMT-ve të bashkive për veprime/mosveprime nga ana e tyre, 128 gjoba të vëna në ndërtimet pa leje, 208 vendim prishje të objekteve të kundërligjshme/pezullimi të punimeve në ndërtim, si dhe 71 gjoba të vëna në fushën e mjedisit, ujërave dhe pyjeve.

Problematikat: Janë hasur lidhur me identifikimin e subjekteve, marrjen e informacioneve nga autoritetet planifikuese dhe inspektuese të qeverisjes vendore në lidhje me dokumentacionin mbi ligjshmërinë e objekteve/ndërtimeve të inspektuara, situata e mbartur e tërmetit të 26 Nëntorit, si edhe viti i pandemisë së COVID-19.

Objektivat: Evidentimi, procedimi dhe prishja e ndërtimeve pa leje/me leje, pas trajtimit sipas legjislacionit në fuqi, konkretisht: në zona të brezit të zhvillimit të kontrolluar dhe zonave me përparësi të turizmit; ndërhyrja ndaj ndërtimeve pengesë për zhvillimet e projekteve me interes publik; bashkëpunimi me strukturat përkatëse për ndërhyrjet emergjente në objekte të dëmtuara rëndë nga fatkeqësitë natyrore.

Evidentimi dhe procedimi i pikave dhe burimeve ndotëse në sipërfaqet ujore dhe grumbullimeve të mbetjeve të ngurta urbane dhe të tokës pyjore, nga ndërhyrjet e pakontrolluara në vend të depozitimeve të paligjshme jashtë landfilleve të miratuara.

Evidentimi e procedimi i rasteve të prerjeve të paligjshme, tregtimit të paligjshëm të materialit drusor, pushtimit, shpërdorimit, degradimit, tjetërsimit të pyjeve në Fondin Pyjor dhe Mjedisin Natyror.

3. MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË

3.1 Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore (ISHPSHSH)

ISHPSHSH, ka ushtruar funksionet në zbatim të VKM-së nr. 295, datë 20.03.2013, “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore” dhe nëpërmjet inspektimit siguron zbatimin e ligjshmërisë në fushën e punës dhe standardeve të shërbimeve të kujdesit shoqëror.

Inspektimet për vitin 2020 janë orientuar në subjekte me historik aksidenti, me problematika lidhur me zbatimin e legjislacionit të sigurisë dhe shëndetit në punë, si dhe me fokus mbrojtjen e popullatës për shkak të pandemisë, duke sjellë edhe një qasje ndryshe dhe më informuese e këshilluese ndaj biznesit, punëdhënësve e punëmarrësve.

Me Urdhër të Kryeministrit nr. 156, datë 24.11.2020, “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Inspektoratit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore”, është miratuar struktura e re me 6 rajone dhe ka filluar zbatimimi i këtij urdhri.

Gjatë mbikëqyrjes së veprimtarisë inspektuese të realizuar online, u konstatua se ISHPSHSH ka kryer 6000 inspektime gjithsej, nga të cilat 2902 të programuara dhe 3098 jashtë programit. Janë marrë 82 masa administrative, nga të cilat 77 janë marrë në inspektime jashtë programi, ndikuar kjo edhe nga situata e krijuar nga pandemia COVID-19.

Nga mbikëqyrja rezulton se ISHPSHSH realizon procedurën e inspektimit online, nëpërmjet paketave portabël dhe me Tabletë, me program vjetor të inspektimit, me dokumente standarde dhe listë-verifikimi, konform formës dhe afateve ligjore të përcaktuar në ligjin nr. 10433/2011, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”. Inspektimet janë realizuar të programuara për muajt Janar, Shkurt, Mars, Qershor dhe Tetor, ndërsa muajt e tjerë, janë realizuar jashtë programi për shkak të pandemisë COVID-19.

Arritjet: Kryerja e inspektimeve online, zhvillimi i platformës “matrica e dënimeve”, duke synuar që kjo platformë të jetë platforma informuese, ndërgjegjësuere dhe e aksesueshme nga punëdhënës e punëmarrës, si në drejtim të marrjes së informacionit bazë mbi detyrimet e legjislacionit të punës, ashtu edhe nëpërmjet koordinimit e planifikimit të inspektimeve mbi bazë risku.

Problematikat: Për sa i përket procesit inspektues, ka disa mangësi në plotësimin e akteve administrative në të gjitha fushat e tyre si: në plotësimin e kohëzgjatjes së inspektimit dhe shtyrjes së autorizimit, në disa raste procedura e inspektimit është realizuar jashtë afateve të përcaktuara në autorizim. Gjetjet e konstatuara nuk pasqyrojnë në mënyrë të detajuar shkeljet e kërkesave ligjore të identifikuar në subjekt, procesverbalit nuk firmoset nga trupa inspektuese

dhe personi i autorizuar i subjektit, si dhe nuk dokumentohet njoftimi i procesverbalit subjektit objekt inspektimi, nuk verifikohet nëse dokumentacioni inspektues është mbajtur pranë dhe në prani të subjektit, pasi procedura nuk është realizuar me Tabletë.

Objektivat: Zhvillimi i mëtejshëm i platformës “matrica e dënimeve”, ngritja e një bërthame me inspektorë pune, të mirë trajnuar për rastet e hetimit të aksidenteve në punë, si raste specifike inspektimi, gjë e cila do të shërbejë në trajnimin e inspektorëve të punës, duke rritur kapacitetet vëzhguese të inspektimit, si rol kyç e parandalues për ngjarje aksidentale në vendin e punës. Forcimi i bashkëpunimit me institucionet e tjera apo me qendrat spitalore, për marrjen në kohë të njoftimit të rasteve të aksidenteve në punë për trajtim ligjor të çdo rasti. Rritja kapaciteteve inspektuese në drejtim të efikasitetit dhe cilësisë së inspektimit. Rritja e kontrolleve në subjektet shtetërore, duke synuar minimizimin e konflikteve të marrëdhënieve të punës, si një trend në rritje kohët e fundit nga rastet e ankesave të adresuara pranë institucionit.

Forcimi i kapaciteteve inspektuese të Drejtorisë së Inspektimit të Standardeve të Shërbimeve Shoqërore, përmes implementimit të programit të Bashkëpunimit me UNICEF, ku Drejtoria e Inspektimit të Standardeve të Shërbimeve Shoqërore, si një nga aktorët kryesorë të reformës së shërbimeve shoqërore, në partneritet me UNICEF, do të përfshijë dhënien e ekspertizës dhe promovimin e inspektimit të shërbimeve sociale në të gjitha forumet, tryezat, grupet e punës, që kanë të bëjnë me qeverisjen lokale, zhvillimin e politikave sociale, si dhe në lidhje me rritjen e kapaciteteve të trupës inspektuese.

3.2 Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut (ISHMT)

ISHMT, sipas VKM-së nr. 36, datë 20.1.2016, “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit Shtetëror të Mbikëqyrjes së Tregut”, është struktura përgjegjëse për inspektimin e zbatimit të kërkesave të detyrueshme ligjore në fushën e mbrojtjes së konsumatorit, mbrojtjes së pronësisë industriale, garantimit të mbrojtjes dhe respektimit të të drejtave të autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me to, si dhe të inspektimit metrologjik, sipas legjislacionit në fuqi për metrologjinë.

Veprimtaria inspektuese e ISHMT realizohet nga trupa inspektuese e përbërë nga 55 inspektorë, ku 37 inspektorë janë pranë Drejtorisë së Mbikëqyrjes së Produkteve dhe 18 pranë Drejtorisë së Pronësisë Intelektuale, drejtori të cilat kryejnë funksione inspektuese.

Numri i inspektimeve për vitin 2020: Për periudhën Janar – Dhjetor 2020, ISHMT ka gjeneruar në sistemin elektronik “*e-Inspektimi*”, 2570 çështje (inspektime) gjithsej, ku 1608 janë inspektime të mbyllura (të realizuara), prej të cilave 1149 inspektime janë të programuara dhe 459 jashtë programit; 429 inspektime të anuluar, 533 inspektime në progres.

Nga mbikëqyrja e veprimtarisë së inspektimit rezulton se ISHMT kryen procedurën inspektuese sipas ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, si dhe ligjeve sektoriale në fuqi. Procesi inspektues kryhet online, nëpërmjet portalit unik “*e-Inspektimi*”, me laptop dhe jo nëpërmjet Tabletave, edhe pse pajisja me Tableta e gjithë trupës

inspektuese është realizuar që prej Nëntorit të vitit 2018, gjë e cila e bën të pamundur verifikimin nëse inspektimi është kryer pranë dhe në prani të biznesit.

Veprimtaria inspektuese është realizuar nëpërmjet programit vjetor të inspektimeve, të hartuar në bazë të prioriteteve dhe kategori subjektsh të ndara sipas këtyre prioriteteve, të miratuar nga autoriteti përgjegjës, si dhe të gjeneruar në sistemin “*e-Inspektimi*”. Programet mujore janë hartuar me listë subjektsh inspektimi, me fushë veprimtarie të përcaktuara, e cila lidhet me tematikën/prioritetin e programit vjetor, por nuk janë të hartuar me bazë risku.

Gjithashtu, konstatohet mospërputhje e subjekteve të programuara për inspektim, sjellë me shpresë pranë Inspektoratit Qendror, krahasuar me subjektet e programuara të gjeneruara në sistem.

Inspektime për kontrollin e zbatimit të protokolleve të sigurisë anti-covid: Në zbatim të Vendimit nr. 15, datë 25.04.2020, “Për krijimin e Task-Forcës për garantimin e zbatimit të protokolleve të sigurisë në kuadër të epidemisë së shkaktuar nga COVID-19”, janë kryer gjithsej 11940 monitorime për kontrollin e zbatimit të protokolleve të sigurisë për COVID 19. Nga monitorimet e kryera ka rezultuar se 2421 subjekte i zbatojnë vetëm pjesërisht masat për parandalimin e përhapjes së COVID-19.

Këto subjekte janë këshilluar për zbatimin e protokolleve të sigurisë, në raste të caktuara janë referuar për masë administrative “gjobë”. 19 subjekte janë referuar për masa administrative pranë organeve kompetente.

Masat administrative dhe ecuria e tyre: ISHMT për vitin 2020, ka marrë gjithsej 318 masa administrative, prej të cilave 24 masa urgjente, 249 paralajmërime dhe 45 gjoba. Lidhur me masat administrative “gjobë” të vendosura, pranë ISHMT-së janë paraqitur 29 ankime administrative, të cilat janë marrë në shqyrtim në mbledhjet e zhvilluara nga Komisioni i Ankimit. Nga 29 ankime administrative, me vendim të Komisionit të Ankimit janë rrëzuar 11 gjoba dhe 18 gjoba janë lënë në fuqi. Janë ndjekur në Gjykatë 10 çështje gjyqësore, nga të cilat 8 çështjeve i është rrëzuar kërkesëpadia nga ana e subjekteve ankimuese; 1 çështjeje i është pranuar kërkesëpadia kundër ISHMT-së dhe 1 çështje është në proces gjyqësor. Masat administrative që kanë marrë formë të prerë janë në proces ekzekutimi nga zyra përmbarimore private me të cilën ISHMT, ka lidhur kontratë shërbimi, ndërsa 7 prej tyre janë ekzekutuar tërësisht dhe janë derdhur në llogarinë e ISHMT-së. Për vitin 2020 janë arkëtuar nga gjobat 3.697.998 lekë.

Arritjet: ISHMT nëpërmjet inspektimeve të kryera, ka ulur mos-konformitetin e produkteve jo-ushqimore, si dhe ka rritur respektimin e të drejtave të pronësisë intelektuale. Nëpërmjet fushatave sensibilizuese ka informuar konsumatorët mbi të drejtat e tyre për të disponuar produkte/pajisje/instalime të sigurt dhe informimin e operatorëve ekonomikë për të respektuar kërkesat ligjore, që janë të shprehura në legjislacionin aktual për të ofruar në treg produkte të sigurt, si dhe për respektimin e të drejtave të pronësisë intelektuale.

Gjithashtu, ka dhënë kontribut për kontrollin e zbatimit të protokolleve të sigurisë anti-covid, si pjesë e Task-Forcës në kushtet e situatës së jashtëzakonshme të krijuar për shkak të COVID-19.

Problematikat: ISHMT është përballur me mungesë automjetesh për inspektim, të cilat sjellin vështirësi në realizimin e planit të inspektimeve. Ka mangësi në vlerësimin e sigurisë së produkteve nëpërmjet aparaturave dhe pajisjeve, gjë e cila lidhet jo vetëm me numrin shumë të kufizuar të këtyre pajisjeve dhe aparaturave, por edhe me mungesën e trajnimeve më të avancuara për përdorimin e tyre.

ISHMT, nuk ka një procedurë për produktet që duhet t'i nënshtrohen analizave laboratorike në laboratorë të huaj, ka mungesë eksperience të stafit në fushën e inspektimit.

ISHMT ndeshet me një shkallë të ulët të informimit të subjekteve, në lidhje me kuadrin ligjor dhe detyrimet që rrjedhin nga ligjet dhe aktet nënligjore të miratuar sipas fushave specifike. Ka mangësi dhe boshllëqe në kuadrin ligjor ekzistues për disa grup-produkte ose për respektimin e të drejtave të pronësisë industriale. Shumë subjekte nuk janë gjetur në adresat që kanë deklaruar në QKB duke sjellë një numër të lartë të inspektimeve që nuk janë realizuar. Në lidhje me dërgimin e vendimeve përfundimtare të inspektimit pranë operatorëve ekonomikë ndeshen vonesa ose pengesa nga Posta Shqiptare.

Objektivat: Kryerja e inspektimeve, duke zbatuar kërkesat ligjore nga subjektet konform legjislacionit në fuqi për ofrimin e produkteve, pajisje/instalime të sigurta për konsumatorin, si dhe për respektimin e të drejtave të pronësisë intelektuale. Informimi i operatorëve ekonomikë për zbatimin e kritereve ligjore, si dhe informimi e ndërgjegjësimi i konsumatorëve mbi sigurinë e produkteve dhe mbi të drejtat e tyre si konsumatorë. Trajnime të vazhdueshme të stafit për rritjen e shkallës së njohurive në fushat përkatëse.

4. MINISTERIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

4.1 Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial (ISHTI)

ISHTI, ushtron veprimtarinë inspektuese në zbatim të VKM-së nr. 410, datë 13.05.2015, “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit Shtetëror Teknik dhe Industrial” dhe është struktura përgjegjëse për garantimin e përmbushjes së kërkesave ligjore dhe nënligjore në fushën e përpunimit, transportimit dhe tregtimit të naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre, sigurisë së punës së pajisjeve dhe instalimeve elektrike, sigurisë së punës së instalimeve nën presion, sigurisë së punës në veprimtarinë e sektorit të gazit natyror, si dhe sigurisë teknike të linjave teknologjike industriale të industrisë jo ushqimore.

ISHTI është i organizur sipas shpërndarjes gjeografike dhe i ndarë me zona:

- Zona Qendër (Tiranë, Durrës, Elbasan, Korçë)
- Zona e Veriut (Lezhë, Shkodër, Kukës, Dibër)
- Zona e Jugut (Fier, Berat, Vlorë, Gjirokastrë)

Nga mbikëqyrja rezulton se ka planifikuar 3244 inspektime për vitin 2020, dhe ka realizuar gjithsej 4079 inspektime online, prej të cilave 3178 janë të programuara dhe 901 inspektime jashtë planit, ku vihet re një rritje e inspektimeve jashtë programit për arsye të pandemisë.

Gjithashtu, janë vendosur në total 64 masa administrative “gjobë”, nga këto 38 janë tituj ekzekutivë dhe 26 janë ankimuar. Nga dosjet e ankimuarra janë rrëzuar 10 kërkesë padi të paraqitura pranë gjykatave administrative dhe ato të rrethit, 10 çështje janë fituar nga ana e subjekteve dhe 6 janë në proces, si dhe janë arkëtuar vullnetarisht 10 gjoba në total me vlerë 20,557,827 lekë.

4.1.1 Drejtoria e Inspektimit të Naftës dhe Gazit (DING) kryen veprimtari inspektuese në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 8450, datë 24.02.1999, “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar, duke garantuar kontrollin e veprimtarisë së personave juridikë, që ushtrojnë veprimtarinë në fushën e përpunimit, transportit dhe tregtimit të naftës dhe gazit, si dhe nënprodukteve të tyre, për t’u siguruar konsumatorëve produkte cilësore.

Për periudhën Janar-Dhjetor 2020, ka realizuar në total 860 inspektime, prej të cilave 728 inspektime janë të programuara dhe 132 inspektime jashtë planit. Trupa inspektuese e kësaj drejtorie ka vendosur në total 26 masa administrative “gjobë”.

4.1.2 Drejtoria e Inspektimit të Pajisjeve Nën Presion (DIPNP), siguron zbatimin e normave dhe kushteve teknike në përdorimin e instalimeve, impianteve dhe pajisjeve nën presion përkatëse nga personat juridikë, që kryejnë veprimtari në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 32, datë 24.03.2016, “Për garantimin e sigurisë së punës së pajisjeve dhe instalimeve nën presion”, monitorimin dhe përdorimin e pajisjeve/instalimit nën presion; montimin e pajisjes/instalimit nën presion; pajisja e punonjësve që përdorin pajisje/instalime nën presion me dëshmi aftësie.

Gjatë vitit 2020, ka realizuar në total 2136 inspektime online, prej të cilave 1460 inspektime të programuara dhe 676 inspektime jashtë planit. Janë vendosur 7 masa administrative “gjobë”. Nga aktiviteti inspektues në operatorët ekonomikë, që shfrytëzojnë pajisje/instalime nën presion janë inspektuar për here te parë, si subjekte te reja, 185 institucione arsimore (shkolla, kopshte, çerdhe dhe konvikte).

4.1.3 Drejtoria e Inspektimit të Pajisjeve, Instalimeve Elektrike dhe Makinerive Ngritëse (DIPIEMN), siguron zbatimin e normave dhe kushteve teknike në përdorimin e instalimeve, impianteve dhe pajisjeve elektrike përkatëse nga personat juridikë, që kryejnë veprimtari në përputhje me ligjin nr. 8734, datë 01.02.2001, “Për garantimin e sigurisë së punës të pajisjeve dhe të instalimeve elektrike”, i ndryshuar, moszbatimi i procedurave të punimit; ndërhyrje të paligjshme në ambiente elektrike për qëllime të ndryshme; trajtimi i rasteve të aksidenteve.

Gjatë vitit 2020, ka realizuar në total 1083 inspektime online, prej të cilave 990 inspektime të programuara dhe 93 inspektime jashtë planit, si dhe ka vendosur 31 masa administrative “gjobë”, prej të cilave 24 gjoba në rastet e aksidenteve në punë. Përgjatë këtij viti kanë ndodhur gjithsej 10 aksidente, nga këto 2 aksidente me plagosje dhe 8 aksidente me pasojë vdekjen, të cilat kanë ardhur si rezultat i moszbatimit të procedurave të punimit nga personeli tekniko-profesional elektrik; instalimit elektrik të pasigurt; ndërhyrjes së paligjshme në rrjetin elektrik për qëllime të ndryshme, etj.

Arritjet: ISHTI, realizon veprimtarinë inspektuese online, konform ligjit për inspektimin dhe ligjeve sektoriale, me dokumentacion standard, mbështetur në programin vjetor dhe programet mujore. Ka përfunduar Laboratori i Porto-Romanos, i cili do të ndikojë drejtpërdrejtë në cilësinë e procesit të analizimit të mostrave të hidrokarbureve dhe do të ulë ndjeshëm kohën e pritjes për subjektet, nga 12 orë që është aktualisht, në 4 orë. Ky laborator do të kontrollojë cilësinë e 80% të hidrokarbureve që do të importohen dhe eksportohen, gjithashtu është përmirësuar cilësia e karburanteve që tregtohet nga subjektet e tregtimit me shumicë dhe me pakicë.

Problematika: Ka mospërputhje midis 220 subjekteve të planifikuara në sistemin “e-Inspektimi” me ato të dërguara për mendim këshillimor, dokumentacioni i veprimtarisë inspektuese në disa raste për DIPIEMN, nuk plotësohet saktë dhe janë kryer inspektime jashtë kohëzgjatjes së përcaktuar në autorizim, procesi inspektues realizohet me paketat portabël dhe jo me Tableta, duke sjellë mungesën e gjurmueshmërisë së inspektimit.

Objektivat: Rritja e nivelit të respektimit të cilësisë sipas standardeve dhe rregullave teknike për naftën, gazin dhe nënproduktet e tyre në tregun e brendshëm, nëpërmjet kontrolleve cilësore rutinë e të planifikuara në të gjithë subjektet e tregtimit të naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre, vazhdimi i ecurisë së punës për krijimin e bazës së të dhënave për regjistrimin e pajisjeve, impianteve dhe instalimeve elektrike dhe pajisjeve nën presion, përgatitja e Kodit Elektrik Shqiptar, si dhe bashkëpunimi me aktorët e tjerë të përfshirë në procesin inspektues për kryerjen e ekspertimeve teknike gjatë aksidenteve, etj.

4.1.4 Drejtoria e Laboratorit Qendror të Kontrollit (DLQK)

Laboratori i Naftës, Gazit dhe Nënprodukteve, ka si objektiv kryerjen me përgjegjësi të analizave laboratorike të naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre, si dhe analizave të detergjenteve të ndryshëm, letrës, lëkurës dhe këpucëve në Laboratorin e Tekstilit.

Analizat kryhen në përputhje me kërkesat e standardeve kombëtare dhe ndërkombëtare që mbulojnë fushën e tij të shërbimit për testimin e kampioneve të marra në dogana, tregun e brendshëm dhe të tretë.

Gjatë periudhës kohore Janar-Dhjetor 2020, janë testuar gjithsej 7353 kampione, nga të cilat 1957 kampione të marra në dogana dhe 5346 kampione të marra për tregun e brendshëm, si dhe 50 kampione janë për palën e tretë. Nga analizimi 10 kampioneve rezultuan me shmangie nga standardi, nga të cilat 4 gazoile dhe 6 GLN.

Laboratori i Tekstilit, ka si synim kryesor futjen e metodikave të reja dhe trajnimin e personelit me qëllim rritjen e cilësisë në kryerjen e analizave dhe përcaktimeve laboratorike, si dhe futjen e aparaturave të reja bashkëkohore në të ardhmen, me qëllim rritjen e numrit të komponentëve të analizuar. Gjithashtu, për këtë periudhë në laborator janë analizuar gjithsej 66 analiza për palët e treta.

Laboratorit të Tekstilit, këtë vit iu shtua edhe një aparat shumë i rëndësishëm “Spektrometër Portativ për Elementët e Dëmshëm”, i cili ka përdorim të gjerë në fushën e plastikës.

Problematikat: Vazhdon ende e pazgjidhur situata me aparatet e defektuara si: rigaku, aparati i përcaktimit të squfurit në vlera të ulëta; aparati i përcaktimit të koksit kondrason në gazoil; aparati i përcaktimit të numrit motorrik të Oktanit në benzinë, aparati i përcaktimit të DVPE-së (presionit të avujve në benzinë). Mbetet emergjent krijimi i kushteve të ventilimit, aspirimit të dhomave ku ruhen kampionet, për limitimin e rrezikut të eksplozimit dhe kontaminimit të personelit është e domosdoshme vendosja e detektorëve për tejkalimin e përqendrimit të nivelit të gazit dhe të avujve hidrokarbure të dëmshëm për shëndetin e personelit dhe eliminimin e ndonjë zjarri të mundshëm, detektorë zjarri dhe sistem fikje zjarri të menjëhershëm, detektorë për rrjedhje gazesh si hidrogjen, oksigjen dhe gaz i lëngshëm, etj.

Objektivat: vazhdim i ecursisë së punës për krijimin e bazës së të dhënave për regjistrimin e pajisjeve, impianteve dhe instalimeve elektrike; certifikimi i inspektorëve të ISHTI-it, në lidhje me veprimtarinë inspektuese të tyre; bashkëpunimi me Pushtetin Vendor dhe me Prokuroritë e rretheve për kryerjen e ekspertimeve teknike gjatë aksidenteve; rritja e bashkëpunimit me DPD dhe DPT, si dhe përgatitja e Kodit Elektrik Shqiptar.

5.1 Autoriteti Kombëtar për Sigurinë dhe Emergjencat në Miniera (AKSEM)

Autoriteti Kombëtar për Sigurinë dhe Emergjencat në Miniera (AKSEM), zhvillon veprimtarinë inspektuese në bazë të ligjit nr. 135/2016, “Për sigurinë dhe shëndetin në punë, emergjencat dhe shpëtimin në veprimtarinë minerare dhe në punimet nëntokësore në veprat hidroenergjetike” dhe VKM nr. 214, datë 20.04.2018, “Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Kombëtar për Sigurinë dhe Emergjencat në Miniera”, si dhe akte të tjera nënligjore në fuqi.

AKSEM, në funksion të përmbushjes së veprimtarisë së tij, kryen inspektime në veprimtaritë minerare dhe ndërtimin e punimeve nëntokësore të veprave energjetike për verifikimin e zbatimit të kërkesave ligjore për sigurinë në punë e mbrojtjen e shëndetit të punonjësve gjatë veprimtarisë së tyre në:

- ✓ Minierat nëntokësore me regjim gazi, të cilat inspektohen jo më pak se 3 (tre) herë në vit;
- ✓ Minierat nëntokësore pa regjim gazi dhe punimet nëntokësore të veprave hidroenergjetike, të cilat inspektohen jo më pak se 2 (dy) herë në vit;
- ✓ Minierat sipërfaqësore, fabrikat e pasurimit dhe impiantet e përpunimit të mineraleve, të cilat inspektohen jo më pak se 1 (një) herë në vit.

Nga mbikëqyrja e realizuar online, nëpërmjet portalit të inspektimit “*e-Inspektimi*”, rezulton se AKSEM, gjatë vitit 2020 ka realizuar 492 inspektime, nga të cilat 474 janë të programuara dhe 18 jashtë programi (4 %), janë marrë 4 masa administrative “gjobë” me vlerë 2 200 000 lekë si dhe 4 dënime administrative kryesore “paralajmërim”.

Nga Komisioni i Ankimit është shqyrtuar vetëm 1 gjobë, e cila është lënë në fuqi dhe të gjitha gjobat janë në proces ekzekutimi.

Arritjet: AKSEM realizon veprimtarinë inspektuese në përputhje me ligjin për inspektimin, me dokumentacion standard, online, nëpërmjet portalit unik të inspektimit “*e-Inspektimi*”, me program vjetor dhe programe mujore të gjeneruara në portalin unik të inspektimit, në përputhje me kërkesat ligjore. Edhe pse viti 2020 ka qenë një sfidë e madhe për të gjithë, AKSEM ka arritur të realizojë 86 % të inspektimeve të programuara në programe mujore.

Objektivat: prioritet mbetet përsëri inspektimi i subjekteve nëntokësorë me regjim gazi, të cilat vlerësohen subjekte me nivel risku të lartë dhe duhet të kontrollohen të paktën 3 herë në vit; subjektet nëntokësore pa regjim gazi, të cilat vlerësohen si subjekte me nivel risku të mesëm, subjekte të veprave hidro-energjitike, inspektimet si rezultat i revokimit të subjekteve minerare.

6.1 Drejtoria e Inspektimit Hekurudhor (DIH)

DIH është struktura përgjegjëse, e cila siguron kontrollin e veprimtarisë inspektuese në hekurudha, referuar ligjit 142/2016, “Kodit Hekurudhor i Republikës së Shqipërisë”, Urdhrit të Ministrit nr. 154, datë 27.10.2010, Rregullores nr. 11, datë 17.09.1988, “Për dhënien, heqjen e dëshmisë së aftësisë dhe shqyrtimin e kundërvajtjeve administrative në hekurudhë”, Rregullores nr. 14, datë 30.09.1988, “Për mirëmbajtjen e vijave hekurudhore”, si dhe është e organizuar në nivel qendror.

DIH, gjatë vitit 2020, ka realizuar 48 inspektime gjithsej, nga të cilat 43 të programuara dhe 5 inspektime jashtë programi, nuk ka asnjë masë administrative me gjobë.

Arritjet: Nga mbikëqyrja rezulton se veprimtaria inspektuese e DIH, është kryer online, konform ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, me dokumente standarde dhe listë-verifikimi.

Problematikat: Të përditësohet baza ligjore tek listë verifikimet, nuk kryhet njoftimi i autorizimit të inspektimit, në zbatim të nenit 32 të ligjit për inspektimin dhe Urdhrit nr. 25 datë 10.08.2018, “Për miratimin e Rregullores “Për përcaktimin e procedurës së inspektimeve, si një proces i rregullt administrativ”, si dhe nuk jepet baza ligjore e mos njoftimit, sipas ligjit sektorial; akti administrativ “listë-verifikimi” nuk plotësohet në të gjitha rubrikat e duhura.

Objektivat: Të përditësohet baza ligjore tek listë verifikimet. Njoftimi i autorizimit të inspektimit duhet të jetë pjesë e dosjes së inspektimit. Të përcaktohet arsyeja e inspektimit në autorizim, nëse është i programuar apo jashtë programi, sipas parashikimeve të ligjit për inspektimin, si dhe akteve të tjera nënligjore në fuqi. Të kryhet procedura e inspektimit me Tablet, për të realizuar gjurmueshmërinë e inspektorëve, saktësi në kohën e hapjes, mbylljes dhe kryerjes së procesit të inspektimit.

Bashkëpunimi me Menaxherët e Infrastrukturës dhe operatorët hekurudhorë për ngritjen e nivelit të sigurisë hekurudhore; Inspektimet online të përmirësohen dhe të jenë në nivele më të larta;

verifikimi i aftësive profesionale për të gjithë punonjësit hekurudhorë, që ushtrojnë funksione të sigurisë; Vazhdimi i bashkëpunimit me Agjencinë e Bashkimit Evropian të Hekurudhave, si dhe autoritetet homologe të rajonit, me synim shkëmbimin e përvojave pozitive mes palëve; Monitorimi në vazhdimësi i segmenteve problematike të vijës hekurudhore, në ndërrueset hekurudhore, në hyrje-daljet e stacioneve, ku shpejtësia e trenave është e kufizuar në kufijtë minimal, kryesisht aksi hekurudhor Elbasan - Mallna - Vorë - Bajzë.

5. MINISTRIA E ARSIMIT SPORTIT DHE RINISË

5.1 Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar (DPAP)

Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar, në zbatim të ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, është autoriteti përgjegjës për ofrimin dhe sigurimin e shërbimit arsimor cilësor në të gjitha institucionet arsimore të sistemit parauniversitar në Republikën e Shqipërisë.

DPAP ushtron funksionet e saj mbështetur në VKM nr. 99, datë 27.02.2019, “Për krijimin, mënyrën e organizimit e të funksionimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar”, si dhe është e organizuar në nivel qendror, nëpërmjet drejtorisë qendrore (DPAP) dhe në nivel rajonal, nëpërmjet drejtorive rajonale të arsimit parauniversitar (DRAP), në Durrës, Fier, Lezhë dhe Korçë. Sektori i inspektimit dhe vlerësimit të cilësisë, është struktura për ofrimin e një shërbimi cilësor në sistemin arsimor parauniversitar nëpërmjet monitorimit, vlerësimit dhe inspektimit.

Nga mbikëqyrja online e sistemit për vitin 2020, rezulton se DPAP nuk është përdorues i sistemit elektronik “*e-Inspektimi*”. Referuar raportit vjetor të saj, kishte parashikuar 6 inspektime të plota, 20 inspektime tematike, si dhe 70 inspektime të orientuara, por për shkak të pandemisë, pati devijime nga programi dhe nuk realizoi të gjitha veprimtaritë e planifikuara, për arsye se procesi mësimor në Mars 2020 e deri në përfundim të vitit shkollor kaloi online. Veprimtaria inspektuese është realizuar jashtë planit për 80 subjekte në shkolla publike dhe private.

Arritjet: Ka realizuar veprimtari profesionale dhe trajnime: si shkrimi i raporteve të inspektimeve për institucionet, shkollat dhe kopshtet e inspektuara, trajnime nga ASCAP, lidhur me monitorimin e planit afatmesëm, planit vjetor, planit ditor dhe veçoritë në kushtet e masave anti-covid, metodologjinë e vlerësimit të performancës së sistemit arsimor parauniversitar, përgatitjen për testimin ndërkombëtar PISA 2021, ka trajtuar 260 ankime nëpërmjet komunikimit zyrtar apo në formë elektronike, në bashkëpunim me ZVAP, etj.

Problematikat: DPAP, për periudhën 2020, nuk ka realizuar inspektime online, por e gjithë veprimtaria inspektuese është realizuar me blloqe, pavarësisht se nga ana e Inspektoratit Qendror, është siguruar infrastruktura e duhur për realizimin e procesit inspektues, duke përshtatur dokumentet standarde të inspektimit sipas ndryshimeve ligjore, që ka pësuar ligji i tyre sektorial, përditësimin e listë-verifikimeve, si dhe implementimin e tyre në sistemin “*e-Inspektimi*”, pajisjen

me 10 Tableta, si dhe trajnimin e trupës inspektuese.

Objektivat: Bashkëpunimi në vazhdim me ASCAP dhe MASR për trajnimin dhe kualifikimin e stafit mësimor apo punonjësve të tjerë është një sfidë edhe për vitin në vijim, inspektimi dhe vlerësimi i zbatimit të kërkesave ligjore nga institucionet arsimore dhe institucionet e varësisë, zgjidhja e ankimeve të ardhura nga nxënës, mësues dhe të tjerë.

6. MINISTRIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural ka në juridiksionin e saj dy Inspektorate Shtetërore.

6.1 Autoriteti Kombëtar i Ushqimit (AKU)

AKU zhvillon veprimtarinë në bazë të ligjit nr. 9863, datë 28.01.2008, “Për ushqimin”, si dhe ndryshimet ligjore të bëra sipas VKM-së nr. 708, datë 09.09.2020, “Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Kombëtar të Ushqimit”, si dhe Urdhri nr. 128, datë 26.10.2020, “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Autoritetit Kombëtar të Ushqimit”, si dhe është struktura përgjegjëse për sigurimin e zbatimit të kërkesave ligjore në fushat e inspektimit të ushqimit për kafshët me origjinë jo shtazore, të ushqimit për kafshët me origjinë shtazore, për mbrojtjen e bimëve dhe inputeve bujqësore, si dhe inspektimet për IPARD.

Referuar situatës së emergjencës së krijuar në Shqipëri, në kuadër të marrjes së masave të veçanta për parandalimin dhe luftimin e përhapjes së infeksionit të shkaktuar nga COVID-19, ka qenë pjesë kryesore e trupave monitoruese të subjektet e inspektimit në kuadër të Task-Forcës, duke kontrolluar zbatimin e protokolleve standarde të miratuara në zbatim të masave shtrënguese higjieno-sanitare, marrjen e masave për pajisjen e personelit me mjete mbrojtëse, dezinfektimin e ambienteve të tregtimit etj, ka dhënë një impakt pozitiv në ndërgjegjësimin e subjekteve.

Nga mbikëqyrja e veprimtarisë së ushtruar për vitin 2020 dhe bazuar në analizën e të dhënave të marra nga sistemi “*e-Inspektimi*”, rezulton se AKU ka kryer 27009 inspektime gjithsej, nga të cilat 17204 të programuara dhe 9805 ose 36% jashtë programit.

Gjatë viti 2020 janë realizuar 68283 inspektime në pikat e kalimit kufitar, jashtë sistemit online të inspektimit, pa procedurë të rregullit ligjore në bazë të ligjit për inspektimin.

AKU, për këtë periudhë ka marrë këto masa administrative: 5200 paralajmërime, 275 gjoba me vlerë 37 510 000 lekë, të shpërndara në drejtoritë rajonale, si dhe bllokim dhe asgjësim të produkteve ushqimore dhe ushqim për kafshët, apo edhe ndërprerje aktiviteti.

AKU, sipas parimit të funksionimit të sistemit “*e-Inspektimi*”, ka regjistruar elektronik të gjobave, por nuk ka të dhëna në lidhje me masat administrative të apeluar apo ankimet e dërguara në gjykatë nga subjektet e inspektuara.

Programi vjetor i inspektimit për vitin 2020, vazhdon të paraqitet me emra konkretë subjektësh, të ndarë sipas muajve dhe hartuar sipas metodologjisë së vlerësimit të riskut të hartuar nga vetë

ky institucion, si dhe programe mujore. Kjo metodologji merr parasysh vetëm riskun e objektit të inspektimit, pra llojin e aktivitetit dhe jo historikun e ligjshmërisë së subjekteve të inspektimit.

Programi vjetor i inspektimeve, gjatë vitit 2020, ka pasur ndryshime për shkak të situatës së krijuar nga COVID-19, për të cilat ka pasur edhe urdhra të Autoriteteve përkatëse, si: Urdhri nr. 156, datë 10.03.2020, “Për marrjen e masave të veçanta administrative gjate kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga COVID-19”, i Ministrisë të Shëndetësisë, si dhe akte të tjera nënligjore në kuadër të situatës së krijuar.

Problematikat: Plani vjetor i inspektimeve, ku për shkak të pandemisë COVID-19 pati ndryshime të detyruara dhe për arsye objektive ky plan, nuk u realizua. Prandaj një plan vjetor i hartuar vetëm me numër inspektimesh në bazë të burimeve njerëzore në dispozicion do të bënte që inspektorët të kryenin aktivitetin e tyre në bazë të akteve të nxjerra, pa pasur nevojë të ndryshohen të gjitha planet mujore të hartuara që në fillim të vitit. Në pikat e inspektimit kufitar inspektimet nuk kryhen online. Mungesa e një rrjeti laboratorik të aftë për të garantuar informacion të besueshëm dhe në kohë mbi sigurinë ushqimore.

Për procedurën e marrjes së vendimit përfundimtar të inspektimit, në disa raste masa administrative është marrë jo në proporcion të drejtë me dëmin e shkaktuar nga shkeljet ligjore të konstatuara gjatë inspektimit. Vërehet mos plotësimi i listë verifikimit, që është një nga dokumentet kyç për procesin e inspektimit, si dhe plotësimi i duhur i procedurës së asgjësimit. Ri inspektimi për të verifikuar shkeljet e konstatuara nuk bëhet në rastet kur lihen detyra për t’u realizuar, nga ana e inspektorëve. Në disa raste procedura e inspektimit në subjekt ka probleme të mënyrës së hapjes së çështjeve në një subjekt disa here, në dokumentimin e ilustrimin e fakteve të mbledhura gjatë inspektimit, nuk jepet arsyeja e përfundimit të inspektimit kur nuk janë justifikuar gjetjet dhe shkeljet, procedura e asgjësimit e pa rregulluar dhe me pasaktësi.

Njohuri të kufizuara dhe mungesë ekspertize të subjekteve të inspektimit, lidhur me sigurinë ushqimore dhe mosnjohje të kuadrit ligjor dhe rregullativ prej tyre, kryesisht në lidhje me sistemin e gjurmueshmërisë dhe implementimin e planit HACCP. Ri inspektimi për të verifikuar shkeljet e konstatuara nuk bëhet në rastet kur lihen detyra për t’u realizuar, nga ana e inspektorëve.

Objektivat: Hartimi dhe zbatimi i një plani strategjik dhe të detajuar për ndërgjegjësimin e konsumatorëve. Përmirësimi i mëtejshëm i kuadrit ligjor dhe manualeve të procedurave standarde të inspektimit, në përputhje me direktivat e BE-së.

AKU, duhet të hartojë programin vjetor të inspektimit me tematika që do të jenë prioritare për garantimin e sigurisë ushqimore në shkallën më të lartë, sipas kërkesave të ligjit nr. 10433/2011, VKM-së nr. 696/2013, si dhe ligjit sektorial. Programet mujore të hartohen dhe të paraqiten në Inspektoratin Qendror, me subjektet që do të inspektohen, në përputhje me legjislacionin sektorial në fuqi dhe historikun e inspektimeve të kryera nga AKU në këto subjekte, në mënyrë që të mbrohet shëndeti i konsumatorit gjatë konsumimit të produkteve ushqimore.

Marrje masash për të hartuar një metodologji të dënimeve administrative dhe trajnuar trupën inspektuese të AKU për marrjen e vendimit të ndërmjetëm dhe përfundimtar të inspektimit. Të inicohet listë verifikimi për procedurën e asgjësimit, si dhe të përmirësohen listë verifikimet sipas metodologjisë së sistemit elektronik “*e-Inspektimi*”. Të hartohet procedurë e veçantë për licencimin shoqëruar me listë verifikimet përkatëse. Trajnimi i inspektorëve edhe për parandalimin e pasaktësive gjatë procedurës së inspektimit, me qëllim mos përsëritjen e tyre.

6.2 Drejtoria e Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakulturës (DSHPA)

DSHPA zhvillon veprimtarinë e inspektimit në bazë të Ligjit nr. 64/2012, “Për Peshkimin”, i ndryshuar, si dhe VKM-së nr.719, datë 20.10.2011, “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Drejtorisë së Shërbimeve të Midhjes dhe Peshkimit, Sarandë”, i ndryshuar.

Spektori i Inspektimit dhe Kontrollit të Peshkimit, kryen aktivitetin inspektues në 2 fusha inspektimi, përkatësisht peshkim dhe akuakulturë, duke siguruar kontrollin e aktivitetit të peshkimit, në ujë apo në tokë, përfshirë portet, pikat e zbarkimit, mjetet e transportit, qendrat e grumbullimit të peshkut, merkatot, pikat e shitjes dhe restorantet, si dhe është përgjegjëse për monitorimin e respektimit të rregullsisë së zënieve që ndodhen në bordin e mjetit lundrues të peshkimit, të magazinuara, transportuara, në përpunim apo të tregtuara, si dhe saktësinë e dokumenteve të tyre.

Spektori i Inspektimit dhe Kontrollit të Peshkimit ka organikë prej 29 inspektorësh të ndarë në 11 Qarqe, aktualisht drejtoria ka një staf të rekrutuar prej 21 inspektorësh.

Gjatë vitit 2020 janë ***kryer 1354 inspektime, nga të cilat 823 inspektime të programuara dhe 531 jashtë programit të inspektimit***, si dhe janë vendosur 43 masa administrative gjobë, me vlerë 5.772.000 lekë. Numri i inspektimeve është reduktuar për shkak të situatës së krijuar nga COVID-19. Përsa i përket masave administrative “gjobë” është riorganizuar baza e të dhënave, si dhe janë vjelë një pjesë e konsiderueshme e gjobave.

Arritjet: Gjatë vitit 2020, e gjithë procedura inspektuese kryhet online, duke rritur transparencën e inspektimeve dhe performancën e inspektorëve gjatë procesit të inspektimit, krijimin e databazës së analizës së riskut dhe funksionimin e metodologjisë së riskut, përmirësimi i dokumenteve standarde për kryerjen e inspektimit online.

Inspektimi në vijën bregdetare, ka pasur një rritje të konsiderueshme të aplikantëve, të cilët kanë kërkuar të pajisen me licencë. Inspektorati i Peshkimit kryen edhe detyrën e agentit tatimor, ku gjatë vitit 2020 ka grumbulluar në masën 95% taksën vjetore të subjekteve që kryejnë aktivitet peshkimi dhe akuakulturë. Ndaj 5% të subjekteve të cilët nuk kanë paguar, është propozuar masa administrative për heqje licence.

Inspektimi në det: DSHPA në bashkëpunim me Policinë e Kufirit dhe Migracionit, si dhe Rojën Bregdetare, kanë kryer patrullime të përbashkëta në orët e vona të natës, mbi evidentimin dhe parandalimin e gjuetisë së paligjshme.

Inspektimi për evidentimin dhe parandalimin në ujëra të brendshëm: Inspektimi në laguna dhe liqene është zhvilluar në liqenin e Ohrit për ndalimin e gjuetisë së Koranit, si dhe në zonat Tushemisht, Piskupat, Lin dhe Udenisht e liqenin e Prespës, të cilat janë pikat më problematike për gjuetinë e Krapit dhe janë vendosur masa administrative dhe sekuestruar rrjetë krapit.

Në liqenin e Shkodrës është ushtruar kontroll në pikat e tregtimit të produkteve peshkore në bashkëpunim me AKU – Shkodër, për tregtimin e Krapit, në tregjet e peshkut dhe është bërë e mundur pajisja me certifikatë origjine. Kontrollë janë ushtruar në lagunat e Vainit, Merxhanit, Patokut, Vilunit, Karavastasë, Nartës dhe Butrintit.

Inspektimi në pikat e tregtimit dhe magazinimit të produkteve peshkore: Inspektime mbi pajisjen e produktit me certifikatë origjine, si edhe në evidentimin e pikave të tregtimit dhe restoranteve, të cilat tregtojnë produkte të ndaluara “Dater”, ku është gjetur 60 kg Dater kontrabandë nga Greqia.

DSHPA ka bashkëpunuar me AKU dhe për çfarëdo situatë të ndodhur në fushën e peshkimit ka shkëmbim informacioni në kohë reale, duke organizuar edhe grupe inspektuese të përbashkëta.

Inspektimi për evidentimin dhe parandalimin e lëndëve plasëse: Mbetet problem në disa zona të izoluara, por duhet theksuar se kjo gjueti klasifikohet si vepër penale më shumë se kundërvajtje administrative, ku është bashkëpunuar me Policinë e Shtetit.

Problematikat e hasura: Mos vënia në funksion e sistemit të monitorimit Blue Box, sistem i cili mungon prej 3 vitesh; mos pajisja me logjistikë me mjete lundruese dhe transporti, pasi vija bregdetare që mbulon një inspektor arrin deri në 70 km, duke sjellë pamundësi të mbulohet pa mjet transporti; organizim të gjuetisë bregdetare nëpërmjet OMP-ve, praktikë kjo e cila ka rezultuar e suksesshme në liqenin e Shkodrës dhe Pogradecit; mungesa e kiteve të inspektimit (laptop dhe printer), për shkak të dorëzimit të tyre për t’u përdorur gjatë pandemisë, nga trupat inspektuese, të cilat ishin pjesë e task-forcës.

Objektivat: Parandalimi dhe evidentimi i gjuetisë së paligjshme; kryerja e inspektimeve për kontrollin e kriterëve ligjore nga subjektet e peshkimit; fuqizimi i kapaciteteve inspektuese; pajisja e inspektorëve me Tablet për kryerjen e inspektimeve; implementimi i listë verifikimeve të reja, të ndara sipas kategorive të inspektimit; fushatë sensibilizuese për subjektet në drejtim të mos tregtimit të specieve të ndaluara; pajisja me mjete transporti tokësore dhe ujore, etj.

7. MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE

7.1 Inspektorati Shtetëror Shëndetësor (ISHSH)

ISHSH ushtron funksionet e saj në zbatim të VKM-së nr. 241, datë 27.3.2013, “Për organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit Shtetëror Shëndetësor”. Në nivel qendror planifikon dhe

bashkërendon veprimtarinë e inspektimit, siguron unifikimin e praktikave të inspektimit, në shkallë vendi, bashkërendon veprimtarinë e laboratorëve dhe siguron kryerjen e analizave nga laboratorë të akredituar, informon publikun për veprimtarinë e inspektimit, jep mbështetje teknike dhe administrative për veprimtarinë e inspektimit, përgatit programin dhe raportin vjetor të inspektimit, si dhe kryen drejtpërdrejt inspektime ndaj subjekteve të mëdha të inspektimit që kryejnë veprimtari me rrezik të lartë. Degët rajonale të ISHSH-së ushtrojnë veprimtarinë e tyre në territorin e qarkut përkatës dhe janë përgjegjëse për inspektimin.

Inspektorati Shtetëror Shëndetësor është institucioni kryesor i ngarkuar për zbatimin e masave të veçanta për parandalimin dhe luftimin e infeksionit të shkaktuar nga COVID-19, masa të cilat rrjedhin prej ligjit 15/2016, “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive” si dhe të gjitha akteve normative të Këshillit të Ministrave dhe urdhrave të Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Pandemia e shkaktuar nga COVID-19 përbën një sfidë globale, jo vetëm për faktin se është një virus i ri dhe i panjohur, por edhe për nga natyra e tij, si dhe fakti se shkakton sëmundje të rëndë tek njerëzit dhe përhapet potencialisht lehtësisht edhe ndërmjet personave që nuk shfaqin simptoma. Rritja e shpejtë e numrit të të infektuarve dhe të atyre që shfaqin forma të rënda të virusit COVID-19 e për pasojë edhe rritja e numrit të të vdekurve, ka detyruar qeveritë në të gjithë botën të marrin masa që vardojnë nga rritja e kapaciteteve spitalore e deri tek vendimet drastike, që limitojnë aktivitetet e që kanë për qëllim ngadalësimin e përhapjes së virusit.

Në këto kushte dhe duke njohur natyrën e koronavirusit të ri, ndalimi i plotë i përhapjes së tij është virtualisht i paarritshëm. Për këtë arsye, qëllimi është rrafshimi i kurbës së epidemisë, e cila në mungesë të këtyre masave shtrënguese do të kishte një pjerrtësi të madhe, që do të përkthehej në një shkallë të lartë infektimi e për pasojë, mbingarkim të sistemeve të kujdesit shëndetësor dhe rritje të fataliteteve.

Nga mbikëqyrja e realizuar online, nëpërmjet portalit të inspektimit “*e-Inspektimi*”, rezulton se ISHSH, gjatë vitit 2020, ka realizuar 10 165 inspektime, nga të cilat 5 161 janë të programuara dhe 5 004 jashtë programi (49 %). Janë marrë 707 masa administrative “gjobë”, nga të cilat 97 % janë marrë në inspektime të realizuara jashtë programi dhe 300 dënime kryesore “paralajmërim”.

Gjatë vitit 2020, pranë ISHSH Qendror janë zhvilluar 7 (shtatë) Komisione të Ankimimit Administrativ të Trupës Kolegjiale të ISHSH, ku janë shqyrtuar 358 masa administrative, nga të cilat 351 masa janë lënë në fuqi dhe vetëm 4 janë anuluar (1%). Për 322 masa administrative janë lëshuar vendime me urdhër ekzekutimi. Janë realizuar 239 procese gjyqësore gjatë vitit 2020, nga të cilat 95 janë fituar, 68 humbur dhe 77 janë në proces.

Arritjet: Inspektime online në zbatim të ligjit për inspektimin, me dokumente standarde dhe listë-verifikimi, si dhe ligjeve sektoriale për fushën e shëndetësisë; monitorime të përditshme të kushteve higjieno-sanitare dhe shëndetësore në qendrat e akomodimit të qytetarëve të dëmtuar nga tërmeti i 26 Nëntorit 2019; informimin dhe pajisjen e të gjitha pikave doganore, që më datën 1 shkurt 2020, me postera paralajmërues për masat mbrojtëse që duhen respektuar në lidhje me mospërhapjen e infeksionit të shkaktuar nga COVID-19, kontrolli i temperaturës, plotësimi i

Formularit të Vlerësimit dhe investigimit për udhëtarët që hyjnë në Shqipëri në pikat e kalimit kufitar ajror dhe detar; Inspektimin e institucioneve të shërbimit shëndetësor publik, spitaleve, klinikave dhe laboratorëve jopublikë, institucioneve arsimore parashkollore dhe shkollore, subjekteve me numër të madh punonjësish si: fasoneri/call-center, fabrika prodhimi, subjekte të furnizimit me ujë të pijshëm, subjekte tregtare dhe detyrimi i tyre për zbatimin e masave anticovid, duke identifikuar të gjitha mangësitë dhe marrjen e masave të sigurisë sipas protokolleve të miratuara; pjesëmarrja në Task-Forcën e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, si institucioni përgjegjës për inspektimin e të gjitha masave të veçanta, sipas urdhrave të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Komitetit Teknik, si dhe pjesëmarrja në “Task-Forcën për garantimin e zbatimit të protokolleve të sigurisë në kuadër të epidemisë së shkaktuar nga COVID-19”, të drejtuar nga Kryeministri.

Objektivat: Për vitin 2021, ISHSH ka si objektiv inspektimet e vazhdueshme për zbatimin e masave të veçanta për parandalimin dhe luftimin e infeksionit të shkaktuar nga COVID-19, masa të cilat rrjedhin prej ligjit nr. 15/2016, “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive” si dhe të gjitha akteve normative të Këshillit të Ministrave dhe urdhrave të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, në funksion të parandalimit të infeksionit të shkaktuar nga COVID-19; inspektimi i shërbimeve parësore shëndetësore publike dhe jo publike (pika ambulatorie, qendra shëndetësore, poliklinika shëndetësore, kabinet imazherie, kabinet dentar dhe shërbim laboratorik); inspektimi i ndërmarrjeve për kujdesin dhe sigurinë e shëndetit në punë; inspektimi i klinikave dhe laboratorëve stomatologjikë publike dhe jo-publike; inspektimi i spitaleve publike dhe jo publike; inspektime në institucione parashkollore, shkollore, institucione të arsimit të lartë dhe subjekte të akomodimit; inspektimet e kryera për akreditimin e institucioneve shëndetësore publike dhe jo-publike; inspektimi i subjekteve të furnizimit me ujë të pijshëm; inspektimet për zbatimin e ligjit për produktet kozmetike; inspektimi i Institucioneve të Ekzekutimit të Vendimeve Penale (IEVP), paraburgimit dhe ambienteve të ndalimit në Drejtoritë e Policisë dhe Komisariate; inspektime për zbatimin e ligjit për mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit; inspektime për zbatimin e ligjit për mbrojtjen e të miturve nga përdorimi i alkoolit, pijeve energjike dhe atyre me sheqer të shtuar, etj.

7.2 Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore (AKBPM)

Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore ushtron veprimtarinë inspektuese në zbatim të ligjit nr. 105/2014, “Për barnat dhe shërbimin farmaceutik”, i ndryshuar, ligjit nr. 89/2014, “Për Pajisjet Mjekësore”, si dhe VKM-së nr. 24, datë 14.1.2015, “Për miratimin e strukturës dhe mënyrës së funksionimit e organizimit të Agjencisë Kombëtare të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore”, të ndryshuar, është struktura përgjegjëse për inspektimin e barnave pranë subjekteve farmaceutike, të cilat kanë të bëjnë me vendosjen në treg, tregtimin me shumicë dhe pakicë, kushtet e ruajtjes së barnave, lëndëve të para dhe ndihmëse e materialeve ambalazhuese, tregtimin dhe eksportimin e barnave të prodhuara nga fabrikuesit vendas, importin e barnave, autorizimin për import, si dhe pajisjeve mjekësore.

Nga mbikëqyrja e realizuar, online, nëpërmjet portalit të inspektimit “*e-Inspektimi*”, rezulton se AKBPM, gjatë vitit 2020, ka realizuar 382 inspektime nga të cilat 291 janë të programuara dhe

91 jashtë programi (23.82 %). Janë marrë 101 masa administrative “gjobë”, nga të cilat 66 janë marrë në inspektime të programuara dhe 35 në inspektime jashtë programi (36.65%), me vlerë 11 950 000 lekë.

Në Gjykatën e Shkallë së Parë janë fituar 4 (katër) procese gjyqësore me vendim të formës së prerë dhe janë humbur 6 (gjashtë) procese gjyqësore. Janë bërë 4 ankime në Gjykatën Administrative të Apelit brenda afateve ligjore dhe është pranuar pjesërisht 1 (një) proces gjyqësor.

Arritjet: AKBPM realizon veprimtarinë inspektuese në përputhje me ligjin për inspektimin dhe ligjet sektoriale, me dokumentacion standard, online, nëpërmjet portalit unik të inspektimit “*e-Inspektimi*”. Viti 2020, ishte një vit shumë i vështirë për shkak të pandemisë së shkaktuar dhe një sfidë e madhe për AKBPM, ku gjatë gjithë periudhës e në vazhdim, duke mos ndërprerë punën as në kohën e karantinës, ka luajtur një rol të rëndësishëm duke u përgjigjur në mënyrë efikase në të gjitha detyrat funksionale në fushën farmaceutike për barna dhe pajisje mjekësore.

Në zbatim të Urdhrit të Inspektorit të Përgjithshëm nr. 28, datë 21.10.2020, “Për bashkërendimin e inspektimeve për zbatimin e protokollove të sigurisë në kuadër të Task-Forcës Anticovid-19”, janë këshilluar subjekte të ndryshme dhe qytetarë për vendosjen korrekte të barrierave mbrojtëse (maskave), për respektimin e protokolleve për parandalimin e infeksionit të shkaktuar nga COVID-19, nga grupe inspektim të vendosura në terren.

Objektivat: Gjatë vitit 2021, AKBPM do të fokusohet në shumëllojshmërinë e barnave në treg, duke ruajtur cilësinë dhe duke rritur disponueshmërinë, ofrimin e shërbimit cilësor farmaceutik të disponueshëm në të gjithë territorin, forcimin e kontrollit dhe inspektimit të pajisjeve mjekësore që vendosen në tregun shqiptar, me qëllim përmirësimin e nivelit të mbrojtjes dhe sigurisë së shëndetit të pacientëve apo përdoruesve të tyre, në përputhje me nivelet e efektshmërisë së pajisjeve mjekësore të siguruar nga prodhuesit.

7.3 Zyra e Mbrojtjes nga Rrezatimet (ZMR)

Zyra e Mbrojtjes nga Rrezatimet, zhvillon veprimtarinë inspektuese në 2 fusha inspektimi, për mbrojtjen nga rrezatimet jonizuese dhe jojonizuese, sipas ligjit nr. 8025, datë 09.11.1995, “Për mbrojtjen nga rrezatimet jonizuese”, i ndryshuar, ligjit nr. 10469, datë 13.10.2011, “Për mbrojtjen nga rrezatimet jojonizuese”, i ndryshuar, si dhe akte të tjera nënligjore që rregullojnë veprimtarinë e saj.

ZMR, në fushën e rrezatimit jonizues, kryen funksione inspektuese ndaj të gjitha subjekteve shtetërore dhe private, që kryejnë veprimtari me lëndë radioaktive dhe pajisje rrezatuese, me qëllim mbrojtjen e punonjësve të ekspozuar profesionalisht ndaj rreziqeve, të popullatës dhe mjedisit, në tërësi, nga rreziqet e mundshme të rrezatimeve, si dhe sigurimin e materialeve radioaktive.

Gjatë vitit 2020, ZMR ka realizuar inspektime në kabinetet e radiologjisë shtetërore dhe private që kanë në përdorim gjeneratorë me rreze X, në qendra ku aplikohet veprimtari me burime të hapura dhe të mbyllura radioaktive, si dhe matje në lidhje me fuqinë e dozës, në ambientet publike dhe në ato ambiente ku stafi është i angazhuar në punë me burime të rrezatimit jonizues. Në bazë të këtyre matjeve është përcaktuar doza efektive vjetore për publikun dhe stafin.

ZMR, për periudhën kohore Janar-Dhjetor 2020, ka realizuar gjithsej 93 inspektime online, prej të cilave 91 inspektime të programuara dhe 2 inspektime të anuluar. Janë marrë 43 masa administrative kryesore, 5 prej të cilave heqje licence dhe 38 paralajmërimë.

Arritjet: Nga mbikëqyrja e veprimtarisë inspektuese, ZMR rezulton se kryen veprimtarinë inspektuese online, në përputhje me ligjin për inspektimin dhe ligjin për mbrojtjen nga rrezatimet jonizuese, me dokumente standarde, listë-verifikimi, si dhe kryen njoftimin paraprak të autorizimit në formë zyrtare.

Problematikat: ZMR nuk kryen inspektime për sa i përket zbatimit të kërkesave ligjore në fushën e mbrojtjes nga rrezatimi jjonizues.

Objektivat: Fillimi i inspektimeve të burimeve të rrezatimit jjonizues, rishikimi i listë verifikimeve me qëllim përmirësimin e tyre dhe reflektimin e kërkesave të reja.

8 MINISTRIA E TURIZMIT DHE MJEDISIT

8.1 Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM)

AKM është institucioni përgjegjës për inspektimin e kërkesave ligjore në fushën e mjedisit dhe ujërave, sipas VKM-së nr. 568, datë 17.07.2019, “Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit”.

AKM-ja e shtrin veprimtarinë në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë. Ajo organizohet në 2 nivele: nivel qendror, përmes Drejtorisë së Përgjithshme dhe nivel rajonal, nëpërmjet 4 Agjencive Rajonale të Mjedisit (ARM). Një ndër qëllimet kryesore të inspektimeve të ushtruara nga AKM, është ruajtja dhe përmirësimi i mjedisit, si një pasuri jetike për brezat e sotëm dhe të ardhshëm, parandalimi dhe pakësimi i rreziqeve ndaj jetës e shëndetit të njeriut, sigurimi dhe përmirësimi i cilësisë së jetës, si dhe përdorimi i matur dhe racional i natyrës e të burimeve të saj, në kuadër të zhvillimit të qëndrueshëm të vendit.

Stafi i AKM: Veprimtaria inspektuese e AKM, realizohet nga trupa inspektuese e përbërë nga 62 inspektorë të mjedisit dhe 26 inspektorë të ujërave.

AKM, nëpërmjet Drejtorisë së Inspektim-Kontrollit, kryen inspektime dhe kontrole përmes një programi mbi bazë risku, për respektimin e kërkesave ligjore të kushteve mjedisore dhe ujore, siç parashikohet në ligj për inspektimin dhe në legjislacionin sektorial në fuqi; si dhe shqyrton

ankesat për masat administrative dhe gjobat e vendosura ndaj subjekteve, në kuadër të aplikimit të përgjegjësive mjedisore, detyrimeve monetare të subjekteve të gjobitura.

Numri i inspektimeve për vitin 2020: Për periudhën Gusht - Dhjetor 2020, AKM ka realizuar 282 inspektime gjithsej, prej të cilave 200 inspektime në fushën e mjedisit dhe 82 inspektime në fushën e ujërave.

Mbikëqyrja online e veprimtarisë së inspektimit: Procedura inspektuese, përgjithësisht, realizohet konform rregullave të ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, si dhe ligjeve sektoriale në fuqi. AKM, ka program të inspektimeve, për periudhën kohore Gusht-Dhjetor 2020, të hartuar në bazë të prioriteteve dhe objektivave, për fushën e mjedisit dhe ujërave, ndërsa për periudhën Janar-Korrik 2020, inspektimet për mjedisin dhe ujërat, janë realizuar nga ISHMPUT, si pasojë e periudhës tranzitore të ristrukturimit të këtij inspektorati.

AKM, për muajin Nëntor dhe Dhjetor, në bazë të Urdhrit nr. 28, datë 21.10.2020, të Inspektorit të Përgjithshëm, “Për bashkërendimin e inspektimeve për zbatimin e protokolleve të sigurisë në kuadër të Task-Forcës Anti Covid-19”, trupa inspektuese ka realizuar inspektime në terren lidhur me zbatimin e masave të sigurisë dhe sensibilizimin e qytetarëve për mbajtjen e barrierave mbrojtëse (maskave).

Inspektimet e ushtruara nga AKM janë kryer me autorizim dhe me njoftim. Procesverbali i inspektimit plotësohet në të gjitha fushat e tij, por në rubrikën “gjetjet e konstatuara”, shpeshherë nuk detajohen gjetjet apo të pasqyrohen të gjitha konstatimet e procedurës inspektuese. Në shumicën e dosjeve të shqyrtuara, u konstatua pasaktësi në përcaktimin e kohëzgjatjes së inspektimit (data/ora) në procesverbalin e inspektimit, krahasuar me kohëzgjatjen e pasqyruar në autorizim apo vendimin përfundimtar, ndërsa ky i fundit, nuk plotësohet në tërësinë e tij dhe nuk pasqyron argumentimin e heqjes së shkeljes së konstatuar.

Masat administrative dhe ecuria e tyre: Për periudhën Gusht – Dhjetor 2020, AKM ka marrë gjithsej 14 masa administrative “gjobë”, në të 4 rajonet e vendit, me një vlerë totale prej 5 000 000 lekë.

Arritjet: Përmirësimi i metodës së raportimit të sistemit për incidentet dhe procesin e shqyrtimit, kryerja e inspektimeve online në portalin unik “*e-Inspektimi*”, për të përmirësuar përputhjen me procedurat e dokumentuara të inspektimit; përfshirje në një task-forcë rajonale, fokusuar në gjetjen e subjekteve me pa përputhshmëri me dispozitat ligjore; krijimi i një lidhje telefonike për raportimin e parregullsive, të mashtrimit dhe incidenteve; krijimi i një zyre të trajnimit për ngritjen profesionale të inspektorëve, etj.

Problematikat: AKM ka mungesë infrastrukture të nevojshme për zhvillimin e aktivitetit, si: mungesa e zyrave për inspektorët; mungesa e bazës materiale (kompjuter, skaner, fotokopje); mungesa e logjistikës (automjete); mungesa e një regjistri elektronik të subjekteve aktive të pajisura me leje mjedisit; mungesa e përmirësimit të listë verifikimeve të inspektimit online, etj.

Objektivat: AKM ka si objektiv zbatimin e akteve ligjore dhe nënligjore, që lidhen me procesin e VNM-ve; parandalimin, kontrollin dhe uljen e ndotjes së ujit, ajrit, tokës dhe ndotjeve të tjera të çdo lloji; ruajtjen, mbrojtjen dhe përmirësimin e natyrës dhe biodiversitetit; mbrojtjen dhe përmirësimin e qëndrueshmërisë mjedisore me pjesëmarrje publike; ndërgjegjësimin e publikut në vendimmarrjen mjedisore; thjeshtimin e procedurave për biznesin etj.

8.2 Agjencia Kombëtare e Bregdetit (AKB)

Agjencia Kombëtare e Bregdetit, në zbatim të VKM-së nr. 568, datë 17.07.2019, “Për miratimin e kompetencave, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Bregdetit”, është institucioni përgjegjës për inspektimin e kërkesave ligjore në fushën e turizmit, duke e shtrirë veprimtarinë e saj në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

AKB, kontrollon zbatimin e kriterëve dhe të kushteve nga subjektet që ushtrojnë veprimtari turistike, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi; ushtron kontroll dhe inspekton në mjediset dhe në dokumentacionin e subjekteve që ushtrojnë veprimtari turistike; inspekton dhe monitoron rregulloren për disiplinimin e zhvillimit të veprimtarive turistike detare, që zhvillohen në zonën bregdetare dhe respektimin e rregullave për përdorimin e pasurisë së patjetërsueshme publike në zonën bregdetare; merr masa, vendos gjoba/masa administrative për shkeljet e konstatuara nga subjektet që ushtrojnë veprimtari turistike, në përputhje me dispozitat e ligjit; si dhe shqyrton ankesat për masat administrative dhe gjobat e vendosura ndaj subjekteve.

AKB organizohet në dy nivele: nivel qendror, përmes Drejtorisë Qendrore (DQ) dhe nivel rajonal, nëpërmjet katër Agjencive Rajonale të Bregdetit (ARB). Veprimtaria inspektuese realizohet nga Drejtoria e Sigurimit të Zhvillimit të Qëndrueshëm të Turizmit dhe Zonave Bregdetare (DSZHQTZB), si dhe trupa inspektuese është e përbërë nga 20 inspektorë në DQ; 3 inspektorë në ARB Lezhë; 3 inspektorë në ARB Durrës; 3 inspektorë në ARB Vlorë dhe 3 inspektorë në ARB Sarandë.

Numri i inspektimeve për vitin 2020: Për periudhën Gusht – Dhjetor 2020, AKB ka realizuar gjithsej 118 inspektime jashtë programit nga DQ, prej të cilave: 18 inspektime me masë administrative “gjobë”; 53 inspektime më masë administrative “paralajmërim” dhe 47 inspektime pa masë administrative. Inspektimet janë realizuara në stacionet e plazhit dhe udhërrëfyesve turistikë.

Mbikëqyrja online e veprimtarisë së inspektimit: AKB veprimtarinë e saj inspektuese e ka filluar nga muaji Gusht 2020 dhe në vazhdimësi, për arsye se kaloi një periudhë tranzitore të ristrukturimit të trupës inspektuese, nga Inspektorati Shtetëror i Mjedisit, Pyjeve, Ujërave dhe Turizmit në AKB, dhe si pasojë gjatë periudhës Gusht-Dhjetor 2020, nuk ka plan inspektimi të hartuar në bazë të prioriteteve dhe objektivave, të miratuar nga autoriteti përgjegjës. Gjithashtu, nuk ka sjellë për mendim këshillimor pranë IQ as programet mujore të inspektimit, të hartuar me listë subjektësh, me fushë veprimtarie të përcaktuar dhe hartuar mbi bazë risku. Inspektimet e realizuara nga AKB për këtë periudhë, janë të gjitha inspektime jashtë programit.

Inspektimet e ushtruara nga AKB, janë kryer me autorizim, por pa njoftim, pasi të gjitha inspektimet janë realizuar jashtë programit. Listë-verifikimet, nuk plotësohen gjithmonë në tërësinë e tyre. Në procesverbalin e inspektimit, në rubrikën “gjetjet e konstatuara”, shpeshherë nuk detajohen gjetjet apo të pasqyrohen të gjitha konstatimet e procedurës inspektuese. Vendimi përfundimtar nuk plotësohet në tërësinë e tij dhe nuk pasqyron detyrat me afat për t’u realizuar nga ana e subjektit, objekt inspektimi.

Monitorime të stacioneve të plazhit: Në total janë monitoruar 300 subjekte, që ushtrojnë veprimtarinë si stacion plazhi përkatësisht në Bashkinë Durrës, Kavajë, Rrogozhinë, Divjakë, Pogradec, Shkodër, Himarë dhe Sarandë, mbi plotësimin e kriterëve dhe standardeve të përcaktuara në VKM nr. 171, datë 27.03.2019, të ndryshuar, si dhe për verifikimin e masave anti – covid 19 të ndërmarra nga subjektet.

Monitorime të strukturave akomoduese: AKB ka verifikuar në total **1797** subjekte nga lista e vënë në dispozicion dhe subjekte të tjera të hasura në terren, duke informuar dhe ndërgjegjësuar subjektet për të proceduar me aplikimin dhe certifikimin e tyre për përmbushjen e këtij detyrimi ligjor të strukturave akomoduese. Nga 1797 subjekte u evidentuan 366 subjekte që janë pajisur me certifikatë kategorizimi apo kanë aplikuar. Pas verifikimit në terren, është kontaktuar në mënyrë të vazhdueshme me subjektet që nuk kishin aplikuar, duke i informuar rreth procedurës së aplikimit, duke ndikuar në rritjen e numrit të subjekteve të pajisura me certifikatë kategorizimi dhe aplikuesve që po përgatitin dokumentacionin përkatës, nga **366** subjekte në **858** subjekte (shtuar me 154 subjekte që aplikuan pas ri kontaktimit dhe 338 që ishin duke plotësuar dokumentacionin për aplikim).

Masat administrative dhe ecuria e tyre: Për periudhën Gusht – Dhjetor 2020, AKB ka marrë gjithsej 18 masa administrative “gjobë”, nga DQ, me një vlerë totale prej 3 310 000 lekë, si dhe 53 masa administrative “paralajmërim”.

Arritjet: AKB, ka informuar të gjithë ato subjekte, të cilët kishin paqartësi për procesin e aplikimit në portalin “e-albania”, duke qenë se ishte hera e parë që për pajisjen me kontratë zhvillohej aplikim online; informimin dhe kontrollin e subjekteve lidhur me përmbushjen e të gjithave kushteve dhe kriterëve ligjore për sigurimin e mbarëvajtjes së sezonit veror, edhe pse në kushtet e vështira të pandemisë; ka informuar dhe ndërgjegjësuar subjektet për të proceduar me aplikimin dhe certifikimin e tyre për përmbushjen e këtij detyrimi ligjor të strukturave akomoduese; ka hedhur bazën për krijimin e data bazës së subjekteve që do të ndihmojnë në llogaritjen e metodologjisë së riskut dhe në eficientë e punës së këtij institucioni; ka përditësuar bazën e të dhënave të përditësuara për strukturat akomoduese, nëpërmjet procesit të verifikimit për pajisjen me certifikatë, etj.

Problematikat: Për vitin 2020, kushtet e pandemisë së shkaktuar nga COVID-19, si dhe ndryshimet në procedurën e miratimit për ushtrimin e veprimtarisë si stacion plazhi, sollën një proces të ri aplikimi, i cili realizohet online. Ka mungesë bashkëpunimi ndërinstitucional, në mënyrë të veçantë në drejtim të shkëmbimit të informacionit, i cili është i nevojshëm për mbarëvajtjen e punës së DSZHQTZB-së dhe kjo është shumë e evidente në komunikimin me NJVV; subjektet kanë vështirësi në përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga ligjet dhe aktet nënligjore të miratuara sipas fushave specifike, si pasojë e mos njohjes së mjaftueshme të këtyre detyrimeve.

Objektivat për vitin 2021: AKB është e angazhuar të kryejë inspektime për kontrollin e kriterëve ligjore nga subjektet në lidhje me fushat që janë në fokusin e punës së drejtorisë; të evidentojë strukturat akomoduese në të gjithë vendin me qëllim përditësimin dhe përmirësimin e data bazës së të dhënave për to, e cila i shërben procesit të inspektimit të tyre; të garantojë një sezon të suksesshëm turistik nëpërmjet kontrollit të zbatimit të kushteve dhe kriterëve në stacionet e plazhit, përgjatë të gjithë zonave bregujore; të hartojë metodologjinë e riskut për subjekte që veprojnë në fushën e agjencive dhe operatorëve turistikë, udhërrëfyesve turistikë dhe stacioneve të plazhit, duke u nisur nga rezultatet e inspektimeve të mëparshme dhe përfshirja e tyre në planin e punës për 2021.

VII Raportimi i veprimtarisë për inspektoratet vendore

Inspektorati Qendror, edhe gjatë vitit 2020, vazhdoi punën për të përfshirë në sistemin “*e-Inspektimi*”, edhe për 22 njësi të qeverisjes vendore e ndarë sipas 4 qarqeve Dibër, Vlorë, Tiranë dhe Gjirokastrë, në bazë të detyrimeve të ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011, “Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë”.

Për këtë IQ, vazhdoi zbatimin e planit të punës lidhur me fazat e implementimit të inspektorateve vendore në sistemin “*e-Inspektimi*”. Inspektorati Qendror në bashkëpunim me 22 bashkitë, identifikuan funksionet e inspektimit që mbulonte çdo bashki, sipas ligjit të qeverisjes vendore nr. 139/2015 “Për qeverisjen vendore”, i ndryshuar. Gjithashtu, u identifikuan edhe inspektorët përkatës që kryenin funksione inspektuese.

Për këtë, IQ hartoi kalendarin për trajnimin e inspektorëve të 22 bashkive në vend dhe jua komunikoi atyre për të bashkërenduar procesin e trajnimit.

Trajnimi i inspektorëve vendorë për 22 bashki, u zhvillua sipas një kurrikule trajnimi për njohjen me kuadrin ligjor për inspektimin, si dhe kryerjen e inspektimeve online nga sistemi elektronik “*e-Inspektimi*”. Trajnimet u zhvilluan në Janar-Shkurt 2020.

Trajnimet u zhvilluan në formën e bashkëbisedimeve me inspektorët vendor, për të sqaruar çdo paqartësi që ata kishin për procesin e inspektimit si një proces i rregullt administrativ. Gjatë trajnimit në çdo bashki janë shpërndarë edhe rregulloret për procesin e rregullt të inspektimit nr. 25, datë 10.08.2018, për të gjithë inspektorët vendor.

Në përfundim të kësaj procedure u trajnuan 573 inspektorë vendor, e ndarë kjo sipas Qarqeve:

- Dibër 121 – inspektor
- Vlorë 120 – inspektor
- Tiranë 249 – inspektor
- Gjirokastrë 83 – inspektor

Gjithashtu, IQ mban dhe përditëson Regjistrin e Inspektorëve vendor në detyrë, i cili u plotësua me të gjitha funksionet inspektuese për secilën Bashki.

VIII. Raport Monitorimi i buxhetit për vitin 2020 për Inspektoratin Qendror

Në zbatim të ligjin nr. 88/ 2019, “Për buxhetin e vitit 2020”, si dhe të Udhëzimit plotësues të Ministrisë të Financave dhe Ekonomisë nr. 01, datë 17.01.2020, “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2020”, Inspektoratit Qendror i është miratuar plani i buxhetit prej 42 100 000 lekë. Me anë të shkresës nr. 19843/1 prot., datë 29.10.2020, “Për pakësim të fondeve të Buxhetit 2020”, plani i rishikuar i buxhetit për IQ bëhet 40 000 000 lekë.

Për vitin 2020, IQ ka realizuar buxhetin në vlerën 34 240 375 lekë, nga totali i akorduar prej 40 000 000 lekë ose 85.6 % e fondit të planifikuar vjetor, sipas pasqyrës si më poshtë:

Llog.ekonomike	Përshkrimi	Plan 2020	Plani i rishikuar 2020	Fakt 2020	Realizimi buxhetor 2020 në %
llog. 600	Paga	25 000 000	22 900 000	21 523 510	93.98 %
llog. 601	Sig.shoq punedh	4 000 000	4 000 000	3 483 624	87.10 %
llog. 602	Shpenzime operative	10 000 000	10 000 000	7 724 509	77.25 %
llog. 606	Ndihma ekonomike	100 000	100 000	0	0
llog. 231	Shpenzime kapitale	3 000 000	3 000 000	1 508 732	50.30 %
	TOTALI	42 100 000	40 000 000	34 240 375	85.60 %

Fondi i Pagave dhe Sigurimeve Shoqërore (zëri 600-601), është realizuar në zbatim të strukturës organizative të miratuar, me VKM nr. 24, datë 03.03.2017, “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Inspektoratit Qendror”, i ndryshuar, me 21 punonjës. Për gjatë vitit 2020, numri i punonjësve faktik ka qenë 18 sipas strukturës.

Fondi për shpenzime kapitale (zëri 231), me financim të brendshëm është akorduar në vlerën **3 000 000 Lekë** (zëri 231), lekë kapitale të Trupëzuara dhe është realizuar në vlerën **1 508 373** lekë.

Ky fond është akorduar për “Blerje Tableta dhe zhvillimi i tyre në sistem”, si edhe “Blerje kompjutera për zyrat e IQ-së dhe pajisje mbrojtëse për serverin”, të cilat do të prokuroheshin nga AKSHI.

Bazuar në shkresën nr. 2935/3 prot., datë 01.12.2020, të AKSHI-t, “Për anulim të procedurës së prokurimit “Blerje pajisje hardware” (blerje tableta, kompjutera dhe pajisje mbrojtëse për serverin), AKSHI njoftoi se nuk mund të vazhdojë të kryejë procedurën e prokurimit dhe IQ realizoi procedurat e prokurimit me blerje me vlera të vogla, në vlerën totale 1 508 373 lekë. Në realizimin e zërave buxhetore të planifikuar për Vitin 2020, IQ-ja ka zbatuar me korrektësi të gjitha detyrimet që rrjedhin nga ligji nr. 10433, datë 16.06.2011, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, si dhe legjislacionin administrativo-financiar shqiptar të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 2, datë 06.02.2012, “ Për procedurat standarde të zbatimit të Buxhetit”.

IX KONKLUZIONE

Inspektorati Qendror, bazuar në objektivat dhe analizën në tërësi të veprimtarisë inspektuese, konkludon se kjo veprimtari ka ardhur duke u përmirësuar dhe standardizuar në të gjithë komponentët e tij, duke bërë që numri inspektime online të rritet dhe procesi inspektues të kryhet në prani dhe pranë biznesit.

Veprimtaria inspektuese do të arrijë efektivitet maksimal nëse do të kryhet në kushtet e një bashkëpunimi reciprok, transparent dhe me përgjegjshmëri me informimin e subjekteve të inspektimit.

- ✓ Inspektoratet Shtetërore përgjithësisht realizojnë veprimtarinë inspektuese në zbatim të ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011, "Për Inspektimet në Republikën e Shqipërisë", VKM nr. 696, datë 16.08.2013, “Për përcaktimin e procedurave të ushtrimit të kompetencave të Inspektoratit Qendror dhe të rregullave për përmbajtjen dhe administrimin e portalit unik “e-Inspektimi”, ligjeve sektoriale, si akteve të tjera nënligjore në fuqi.
- ✓ IQ, ka ushtruar rolin e tij udhëheqës për bashkërendimin dhe koordinimin e trupave inspektuese për kontrollin zbatimit të masave anti-covid.
- ✓ Veprimtaria inspektuese e ISH-ve kryhet me programin vjetor/mujor të hartuar, këshilluar dhe miratuar nga autoritetet përgjegjëse, por për shkak të pandemisë pati devijime nga programi për periudhën Mars - Maj dhe Nëntor - Dhjetor 2020, për IQ, ISHSH, AKU, ISHMT, AKBPM, ISHPSHSH dhe AKM, të cilat zhvilluan aktivitetin institucional edhe për zbatimin e masave anti-covid.
- ✓ Veprimtaria inspektuese në disa prej Inspektorateve Shtetërore realizohet nëpërmjet laptopëve dhe jo tabletave, gjë e cila bën të pamundur verifikimin nëse dokumentacioni inspektues është mbajtur pranë dhe në prani të subjektit, në zbatim të pikës 2, të nenit 45, të

ligjit për inspektimin.

- ✓ Në sistemin “*e-Inspektimi*”, nuk pasqyrohet ecuria e masës administrative përveç DSHPA, (ankimuar ose jo, papaguar/paguar, data e pagesës dhe kësti), në kundërshtim të pikës 10, të Kreut XIII, të VKM nr. 696, datë 16.08.2013, “Për Përcaktimin e Procedurave të Ushtrimit të Kompetencave të Inspektoratit Qendror dhe të Rregullave për Përmbajtjen dhe Administrimin e Portalit Unik “*e-Inspektimi*”.
- ✓ Ka inspektorate shtetërorë, të cilat nuk kanë realizuar rekomandimet e lëna nga raporti paraardhës.
- ✓ Ka mangësi në plotësimin e rubrikave të listë-verifikimit, të procesverbalit të inspektimit dhe vendimit përfundimtar dhe në disa raste nuk ka shpjegime të detajuara për gjetjet e konstatuara.
- ✓ Janë integruar 22-Inspektorate Vendore në sistemin unik të inspektimeve “*e-Inspektimi*”, duke i mbështetur nga ana metodologjike për përshtatjen e dokumenteve standarde, hartimin e listë-verifikimeve dhe janë pajisur me 26 tableta dhe 5 kite inspektimi.
- ✓ Janë trajnuar 573 inspektorë vendor, si dhe janë pajisur edhe me rregulloret për procesin e rregullt të inspektimit, sipas Urdhrit nr. 25, datë 10.08.2018, “Për Miratimin e Rregullores për Përcaktimin e Procedurës së Inspektimeve, si një Proces i Rregullt Administrativ”.
- ✓ Është mbajtur dhe përditësuar regjistri kombëtar i inspektorëve shtetërorë/vendore sipas Kreut V, të VKM nr. 696, datë 16.08.2013, “Për Përcaktimin e Procedurave të Ushtrimit të Kompetencave të Inspektoratit Qendror dhe të Rregullave për Përmbajtjen dhe Administrimin e Portalit Unik “*e-Inspektimi*”.
- ✓ Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit dhe Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar, nuk kryejnë ende inspektime online.

X REKOMANDIME

Inspektorati Qendror, pas mbikëqyrjes së veprimtarisë inspektuese ka identifikuar edhe problematika duke dhënë rekomandime për përmirësimin e mëtejshëm të veprimtarisë inspektuese për vitin 2021, sa vijon:

- ✓ Të hartohet programi vjetor/mujor i inspektimit tematik dhe me metodologji të vlerësimit të riskut, në zbatim të Urdhrit nr. 6, datë 19.02.2015, “Për miratimin e rregullave të përgjithshme bazë mbi metodologjinë e vlerësimit të riskut”.
- ✓ Të pasqyrohet ecuria e masës administrative (ankimuar ose jo, papaguar/paguar, data e pagesës dhe kësti), në modulën “gjoba”, për të gjitha ISH/trupat e tjera inspektuese në zbatim të pikës 10, të Kreut XIII, të VKM nr. 696, datë 16.08.2013, “Për Përcaktimin e Procedurave të Ushtrimit të Kompetencave të Inspektoratit Qendror dhe të Rregullave për Përmbajtjen dhe Administrimin e Portalit Unik “*e-Inspektimi*”.

- ✓ Për të përditësuar Regjistrin Kombëtar të Inspektorëve Shtetërorë/Vendorë, të dërgohet informacion në kohë pranë IQ, për çdo emërim në detyrë ose për çdo lirim nga detyra të inspektorëve, sipas pikës 3 dhe 4, të Kreut V, të VKM nr. 696, datë 16.08.2013, “Për Përcaktimin e Procedurave të Ushtrimit të Kompetencave të Inspektoratit Qendror dhe të Rregullave për Përbajtjen dhe Administrimin e Portalit Unik “*e-Inspektimi*”.
- ✓ Të përdorin tabletat gjatë kryerjes së veprimtarisë inspektuese online, në mënyrë të tillë që të ndiqet gjurmueshmëria e procesit inspektues dhe dokumentet e gjeneruara në sistem të jenë të nënshkuara nga kryeinspektori, inspektorët dhe subjekti i inspektimit.
- ✓ Të programohet saktë lista e subjekteve në sistemin “*e-Inspektimi*”, si dhe të jetë e njëjtë me listën e subjekteve sjellë me shkresë pranë Inspektoratit Qendror.
- ✓ Të vazhdojë njoftimi për subjektet e programuara, jo më vonë se 7 ditë para fillimit të inspektimit, si dhe të ngarkojë në sistem dokumentin e njoftimit, në zbatim Urdhrit nr. 25, datë 10.08.2018, “Për Miratimin e Rregullores për Përcaktimin e Procedurës së Inspektimeve, si një Proces i Rregullt Administrativ”.
- ✓ Të përditësohen listë-verifikimet dhe dokumentet standarde në përputhje me ndryshimet ligjore, rast pas rasti për çdo Inspektorat Shtetërorë/trupa të tjera inspektuese.
- ✓ Gjatë kryerjes së procesit inspektues të plotësohen të gjitha rubrikat dhe në mënyrë të saktë, të listë-verifikimit, të procesverbalit të inspektimit dhe vendimit përfundimtar, si dhe të ketë shpjegime të detajuara për gjetjet e konstatuara.
- ✓ Veprimtaria inspektuese të dokumentohet sa më shumë të jetë e mundur edhe me dokumente justifikuese, si foto/video, të cilat të ngarkohen në sistemin “*e-Inspektimi*”.
- ✓ Të mbikëqyren dhe të mbështeten me suport teknik Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit dhe Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar, të cilat akoma nuk kryejnë inspektime online.
- ✓ Të vazhdojë procesi i kryerjes së inspektimeve të përbashkëta nën koordinimin e Inspektoratit Qendror, me qëllim zvogëlimin e kostos administrative ndaj subjekteve të inspektimit.
- ✓ Të rritet sa më shumë të jetë e mundur informimi i biznesit dhe qytetarëve për të gjitha aktivitetet, ndryshimet ligjore të propozuara dhe/ose të miratuara, për të qenë transparent dhe efektiv për detyrimet që i lindin atyre për zbatimin e ligjit dhe akteve nënligjore.